

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.7/8, Korrik - Gusht 2023

SHËN BARTOLOMEU (NATANAEL) APOSTULL



Më 24 gusht Kisha e feston Shën Bartolomeun (Natanaelin) apostuj. Emri. Fjala Bartolomei rrjedh nga fjala arameje "bar-Tôlmay" në gjuhën shqipe do të thotë biri i Tolmajit. I lindur në Kanë të Galileës në shekullin e parë, e dërgoi të Jezusi apostulli Filip. Ishte një prej dymbëdhjetëve të apostujve dhe emrat e Dymbëdhjetë apostujve janë këta: i pari Simoni, që quhet Pjetër e vëllai i tij Andreu; Jakobi i Zebedeut dhe Gjoni, i vëllai; Filipi dhe Bartolomeu; Toma e Mateu tagrambledhësi; Jakobi i Alfeut dhe Tadeu; Simon Kananeu dhe Judë Iskarioti ai që e tradhtoi (Mt 10, 2-4). Te veprat e Apostujve është i pranishëm gjatë ngjitjes në Qiell të Jezusit. Kurse te ungjilli i Mateut i Markut dhe i Lukës Bartolomeu është në shoqëri me Filipin apostull. Ndërsa në ungjillin e Gjonit quhet edhe Natanael (Të nesërmen Jezusi vendosi të shkojë në Galile. Takoi Filipin dhe i tha: "Eja pas meje!")

Filipi ishte nga Betsaida, prej qytetit të Andreut e të Pjetrit

Filipi takoi Natanaelin dhe i tha: "E gjetëm atë, për të cilin shkroi Moisiu në Ligj dhe Profetët: Jezusin, birin e Jozefit, nga Nazareti." (Gjn 1,45-51). Po ashtu sipas Gjonit në fund të ungjillit paraqet Natanaelin në mesin e nxënësve që Jezusi u tregohet pas ngjallës në liqenin e Tiberit.

Sipas Euzebit nga Cezareja Shën Bartolomeu pas ngjitjes Jezusit në Qiell shkoi në misione në Indi, ku e lënë kopjen e ungjillit të Mateut. Sipas disa shkrimeve ai ka mësuar në Mesopotami, Iran, Likoni etj. Sipas traditës, së bashku me Juden Tade ka predikuar ungjillin (lajmin e mirë) në Armeni (Kisha apostolike e Armene e ka për pajtor). Në shekullin 13 ndërtohet kuvendi (manastiri), ku mendohet se Shën Bartolomeu vdiq i martirizuar në mënyrë më brutale, ku e rrijepnin për të gjallit dhe ja presin kokën. Martirizimin e Shën Bartolomeu e pikturoi në kapelen Sikstine në Vatikan: Michelangelo: gjyqi i fundit ku Shën Bartolomeu e mbanë në dorë lëkuren e vetë. Në këtë lëkurë artisti e pikturoi portretin e vetvetes.

Reliktet e Shën Bartolomeu ndërrojnë prej një vendit në vendin tjetër. Fillimisht ishin në Siri, në shekullin e VI barten nga Lindja në Perëndim në ishujt Lipar (në detin Etrusk), pastaj në qytetin Benevent, nga perandori Otoni II i sjell në Romë gjatë vitit 983, ku gjenden në kishën e Shën Bartolomeut. Një pjesë e tjetër të relikteve janë në Frankfurt të Gjermanisë dhe në katedralen e Canterbury në Angli.



Rubens, c. 1611

Shën Bartolomeun e festojnë përveç Kishës katolike me 24 gusht, edhe Kisha anglikane, Luteriane si edhe disa kisha Protestante, kurse kisha Ortodokse e feston me 11 korrik. Shën Bartolomeu është mbrojtësi i artizanallëve veçanti gjërave që përpunohen nga lëkura, lëkurëpunuesve, barinjve, fshatareve, sëmundjeve e lëkurës si dhe sëmundjet nervore.

Don Nosh Gjollaj



Papa Françesku në Portugali JEZUSI ËSHTË SHNDËRRUAR!	4
Papa Françesku në Portugali VIRGJËRËS MARI I ËSHTË DASHUR TË UDHËTOJË PËR TË PARË ELIZABETËN!	6
Papa Françesku MESAZHI I ATIT TË SHENJTË	8
Imzot Angelo Massafra OFM FORUMI PËR DIALOGUN DHE PAQEN NË BALLKAN	10
Imzot Angelo Massafra OFM FORUMI PËR DIALOGUN DHE PAQEN NË BALLKAN - DEKLARATA PËRFUNDIMTARE	12
Moter Marjeta Gjoka KISHA SI «MISHËRIM» I LIRISË DHE BESNIKËSISË	14
Motër Dila Shtjefni PERSPEKTIVA E TË NGRITURIT TË VIRGJËRËS MARI NË QIELL NISUR NGA NGJALLJA E JEZUSIT	17
Arqidioqeza Shkodër-Pult SHTATOR: MUAJ LUTJE PËR BOTËN E KRIJUAR	20
Redaksia KAMPET VERORE NË KRYEDIOQEZËN TONË	21
Don Lush GJERGJI PROFETI I MADH I EKUMENIZMIT ATENAGORA I	24
Redaksia SHËN LUIGJ GONZAGA DHE NDRE MJEDA	30
Redaksia SHËN RROKU, PAJTORI I FAMULLISË SË SHIROKËS	31
Redaksia VITRINË LIBRI	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVI, nr. 7/8 (569 - 570) Korrik - Gusht 2023

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



JEZUSI ËSHTË SHNDËRRUAR - «FYTYRA I SHKËLQEU PORSI DIELLI»

Udhëtimi Apostolik i Shenjtërisë së tij Françeskut
në Portugali, me rastin e Ditës XXXVII Botërore të Rinisë
(2 - 6 gusht 2023)

Mesha e Shenjtë dt. 6 gusht 2023

Fjalët e Pjetrit Apostull në Malin e Shndërrimit janë ato që pas këtyre ditëve intensive duam t'i bëjmë tonat: «Zotëri, është mirë për ne të rrimë këtu!» (Mt 17,4). Është e bukur ajo që kemi përjetuar me Jezusin, ajo që kemi jetuar së bashku dhe si jemi lutur. Por, pas këtyre ditëve të hirit, pyesim veten: çfarë marrim me vete duke u kthyer në luginën e jetës së përditshme?

Bazuar në Ungjillin që kemi dëgjuar, do të doja t'i përgjigjem kësaj pyetjeje me tri folje: *shkëlqe, dëgjo, mos ki frikë*.

Shkëlqe:

Jezusi është shndërruar dhe – thotë teksti – «fytyra i shkëlqeu pors dielli» (Mt 17,2). Ai, pak kohë më parë, kishte kumtuar mundimin dhe vdekjen e tij në kryq, duke shkërmoqur kështu përfytyrimin e një Mesie të pushtetshëm dhe mondan dhe duke zhgënjyer pritshmëritë e dishepujve. Tani, pikërisht për t'i ndihmuar ata që ta pranojnë planin e dashurisë së Hyjit, i cili arrin në lavdi përmes rrugës së kryqit, Jezusi merr tre prej tyre, Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin, i çon në mal dhe shndërrohet: fytyra e tij bëhet e shndritshme dhe petkat e tij të bardha. Kjo «banjë drite» i përgatit ata për natën që do të

duhet të kalojnë; kjo pamje e ndritshme do t'i ndihmojë ata për të përballuar mundimet e orëve më të errëta, ato të Gjetsemanit dhe Kalvarit.

Miq, edhe ne kemi nevojë për disa rreze drite për të përballuar errësirën e natës, sfidat e jetës, frikën që na shqetëson, errësirën që shohim shpeshherë rreth nesh. Ungjilli na zbulon se kjo dritë ka një emër. Po, kjo dritë që erdhi për të ndriçuar botën është Jezusi (krh. Gj 1,9). Ai është drita që nuk perëndon kurrë dhe ndriçon edhe natën. Më kujtohen fjalët e priftit Esdra, të cilat i gjejmë në Shkrimin e Shenjtë e të cilat mund t'i përsërisim edhe ne pas këtyre ditëve të kaluara së bashku: «Hyji ynë u dha dritë syve tanë»





(Esd 9,8). Të ndriçuar nga Krishti, edhe ne jemi “shndërruar”: sytë dhe fytyrat tona mund të shkëlqejnë me një dritë të re. Vëllezër dhe motra, kjo është ajo që Kisha dhe bota presin prej jush: që të jeni të rinj ndriçues, që e çojnë ngado dritën e Ungjillit dhe që përftojnë rrezatime shprese në errësirën e kohës sonë!

Dëshiroj t'ju them një gjë: nuk bëhemi të ndritshëm kur vihem qendër të vëmendjes, kur shpërfaqim një imazh të përsosur dhe ndihemi të fortë e të suksesshëm. Jo. Ne shkëlqejmë kur, duke pranuar Jezusin, mësojmë të duam si ai, sepse kjo është bukuria e vërtetë që shkëlqen: një jetë që rrezikon për dashurinë. Një filozof ka shkruar se bukuria e mesazhit revolucionar të Krishtit qëndron në faktin që «atë që është i padëshirueshëm e sheh si të denjë për dashuri» (S. Kierkegaard, *Gli atti dell'amore*, Milano 1983, 579), domethënë të duash të afërmin ashtu siç është: jo vetëm kur ai është në sintoni me ne, por edhe kur s'kemi simpati për të dhe ka anë që nuk na pëlqejnë. Me dritën e Jezusit kjo është e mundur! Ju të rinj mund të doni në këtë mënyrë dhe të rrëzoni disa mure, disa paragjykime, duke sjellë në botë dritën e dashurisë që shpëton. Shkëlqefshi gjithmonë me këtë dashuri, shkëlqefshi Jezusin, «drita e botës» (Gjn 8.12)!

Folja e dytë është *të dëgjosh*. Në mal, një re e ndritshme i mbuloi dishepujt dhe zëri i Atit tregon se Jezusi është Biri i dashur. Urdhri që dorëzon Ati është i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë: «Dëgjoni atë» (Mt 17,5). Gjithçka qëndron këtutë: gjithçka që duhet bërë në jetën e krishterë qëndron në këtë fjalë, e fundit që Ati shqipton në Ungjillin e Mateut: dëgjojeni atë. Të dëgjojmë Jezusin, të bisedojmë me Të, ta lexojmë Fjalën e tij dhe ta vëmë në jetë, ta ndjekim: sepse Ai ka fjalë të jetës së pasosur për ne; sepse Ai zbulon se Hyji është Atë dhe dashuri; sepse falë Shpirtit të tij edhe ne bëhemi bij të dashur. Kjo është ajo që na duhet në jetë: jo fama, suksesi, paratë, por të dimë se nuk jemi vetëm, se kemi gjithmonë Dikë pranë, që ta fillojmë dhe ta mbyllim ditën me sigurinë e përqaimit të Zotit; ta dëgjojmë atë, për të besuar se jemi të dashur dhe të shoqëruar nga një dashuri që nuk mungon kurrë. Dhe le ta kujtojmë këtë: të dëgjuarit e Zotit, duke qëndruar i hapur ndaj surprizave të tij, na bën njerëz të aftë për të dëgjuar njëri-tjetrin, për të dëgjuar realitetin që na rrethon, kulturat e tjera, zërin e vuajtur të të varfërve dhe më të brishtëve, britmën e Tokës së plagosur dhe të keqtrajtuar. Sa bukur është të dëgjosh Jezusin, ta dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të rritemi në dialog, në një botë ku kaq shumë njerëz udhetojnë të mbyllur në vetminë e tyre, duke menduar për veten e tyre.

Shkëlqeni, dëgjoni dhe së fundi, *mos kini frikë*. Këto janë fjalët e fundit që Jezusi thotë në mal për t'u dhënë zemër dishepujve të frikësuar: «Çohuni e mos u trembni» (Mt 17,7). Tani që ata kanë pasur një hershim të lavdisë pashkore, që janë zhytur në dritën hyjnore dhe kanë dëgjuar zërin e Atit, dishepujt mund të zbresin nga mali dhe të përballen me sfidat që i presin poshtë. Kështu është edhe për ne: nëse e ruajmë dritën e Jezusit dhe fjalët e tij, ne mund të ecim në jetë çdo ditë me një zemër të liruar nga frika.

Juve, të rinj, që kultivoni ëndrra të mëdha, por shpesh të errësuar nga frika se s'do t'i shihni të realizuara; juve, të rinj, që ndonjëherë mendoni se nuk ia dilni dot; juve, të rinj, të tunduar në këtë kohë për t'u shkurajuar, për ta gjykuar veten të papërshtatshëm ose për ta fshehur dhimbjen tuaj duke e maskuar atë me një buzëqeshje; juve, të rinj, që dëshironi të ndryshoni botën dhe të luftoni për drejtësi dhe paqe; juve, të rinj, që keni ofruar mundin dhe imagjinatën tuaj, por ju duket se nuk mjaftojnë; juve, të rinj, që Kisha dhe bota kanë nevojë si toka për shiun; juve, të rinj, që jeni e tashmja dhe e ardhmja; po, pikërisht juve të rinj, Jezusi u thotë: «Mos u trembni!».

Fjalët që shën Gjon Pali II tha gjatë njëres prej DBR-ve jehojnë më të gjalla se kurrë: «Në realitet, është Jezusi ai që ju kërkoni kur ëndërroni për lumturinë; Ai është që ju pret kur asgjë nuk ju kënaq nga ajo që gjeni; Ai është bukuria që ju tërheq aq shumë; është Ai që ju provokon me atë etje për rrënjësoren që nuk ju lejon të përshtateni me kompromise; është Ai që ju nxit të hiqni maskat që e bëjnë jetën false; është Ai që jua lexon në zemër vendimet më të vërteta që të tjerët do të donin t'i mbysnin. Është Jezusi ai që ju ngjall dëshirën për të bërë diçka të madhe me jetën juaj. [...] Mos kini frikë t'i besoni Atij» (Vigjilja e Lutjes, Romë, 19 gusht 2000).

Të dashur të rinj, do të dëshiroja që ta shihja secilin prej jush në sy dhe t'i thoja: mos ki frikë! Por po ju them diçka shumë më të bukur: vetë Jezusi ju shikon tani, Ai që ju njeh dhe ju lexon brenda: ju shikon në zemër, ju buzëqesh dhe ju përsërit se Ai ju do gjithmonë dhe pafundësisht. Gjithmonë dhe pafundësisht. Shkoni, atëherë, dhe çojuni të gjithëve buzëqeshjen rrezatuese të Hyjit! Shkoni dhe dëshmoni gëzimin e fesë, shpresën që ju ngroh zemrën, dashurinë që vini në çdo gjë. Shkëlqeni prej dritës së Krishtit. Dëgjoni Atë që të bëheni edhe ju dritë e botës. Dhe mos kini frikë, sepse Zoti ju do dhe ecën përkrah jush. Me Të jeta ngjallet, gjithmonë.



VIRGJËRËS MARI I ËSHTË DASHUR TË UDHËTOJË PËR TË PARË ELIZABETËN!

*Udhëtimi Apostolik i Shenjtërisë së tij Françeskut
në Portugali me rastin e ditës XXXVII botërore të rinisë
(2 - 6 gusht 2023)*

Fjalimi:

“Parku i Tejos” (Lisbonë)

E shtunë, 5 gusht 2023

Të dashur vëllezër e motra, mirëmbërma!

Gëzohem shumë tek ju shoh këtu! Faleminderit që keni udhëtuar, që keni ecur dhe faleminderit që jeni këtu! Mendoj se edhe Virgjërës Mari i është dashur të udhëtojë për të parë Elizabetën: “U nis nxitim” (Lk 1,39). Lind pyetja: pse Maria ngrihet dhe shkon me nxitim te kushërira e saj? Natyrisht, sapo ka mësuar se kushërira e saj është shtatzënë, por edhe ajo vetë është shtatzënë: pse duhej të shkonte kur askush nuk ia kishte kërkuar këtë gjë? Maria kryen një gjest të pakërkuar dhe të pa detyruar; Maria shkon, sepse dashuron dhe “ata që dashurojnë fluturojnë, vrapojnë të lumtur” (*Imitimi i Krishtit*, III,5). Kjo është ajo që bën dashuria.

Gëzimi i Marisë është i dyfishtë: sapo kishte marrë kumtimin e engjëllit se do të mikpriste Shëlbuesin dhe lajmin se kushërira e saj ishte shtatzënë. Është diçka interesante: në vend që të mendojë për veten e vet, ajo mendon për tjetrën. Pse? Sepse gëzimi është misionar, gëzimi nuk është për një person të vetëm, është për t’ia çuar atë dikujt tjetër. Po ju pyes: ju, që jeni këtu, që keni ardhur për ta takuar njëri-tjetrin, për të gjetur mesazhin e Krishtit, për të gjetur një kuptim të bukur në jetë, këtë gjë do ta mbani këtë për vete apo do t’ua çoni të tjerëve? Çfarë mendoni? Nuk ju dëgjoj... Për t’ua çuar të tjerëve, sepse gëzimi është misionar! Ta përsërisim të gjithë së bashku: gëzimi është misionar! Dhe kështu unë ua çoj të tjerëve këtë gëzim.

Këtë gëzim që ne kemi sot, kanë qenë të tjerë persona që e kanë përgatitur për ne. Të shikojmë pas, gjithçka që kemi marrë: e gjithë kjo e ka përgatitur zemrën tonë për ta mikpritur gëzimin. Të gjithë, po ta kthejmë kokën pas, kemi persona që kanë qenë një rreze drite për jetën tonë: prindër, gjyshër, miq, priftërinj, rregulltarë, katekistë, animatorë, mësues... Ata janë si rrënjët e gëzimit tonë. Të bëjmë një moment qetësie dhe secili të mendojë për ata që na kanë dhënë diçka në jetë, që janë si rrënjët e gëzimit tonë.

A keni gjetur ndokënd? A keni gjetur fytyra, histori? Gëzimi që ka ardhur përmes këtyre



rrënjëve është ai që ne duhet të japim, sepse ne kemi rrënjë gëzimi. Në të njëjtën mënyrë ne vetë mund të jemi rrënjë gëzimi për të tjerët. Nuk bëhet fjalë për të sjellë një gëzim kalimtar, një gëzim të momentit; bëhet fjalë për të sjellë një gëzim që krijon rrënjë. Dhe pyes veten: si mund të bëhemi rrënjë gëzimi?

Gëzimi nuk qëndron në bibliotekë, i mbyllur - edhe pse është e nevojshme të studiojmë! - por është diku tjetër. Nuk mbahet i mbyllur me çelës. Gëzimin duhet ta kërkojmë, ta zbulojmë. Duhet ta zbulojmë në dialog me të tjerët, ku duhet t’i japim këto rrënjë gëzimi që kemi marrë. Dhe kjo, ndonjëherë, të lodh. Po ju bëj një pyetje: a lodheni ndonjëherë? Mendoni se çfarë ndodh kur dikush është i lodhur: nuk dëshiron të bëjë asgjë, siç themi në spanjisht, hedh peshqirin, sepse nuk dëshiron të vazhdojë më dhe pastaj dorëzohet, ndalon së ecuri dhe rrëzohet. A besoni se jeta e një personi ka marrë fund nëse ai rrëzohet në jetë, nëse dështon në diçka apo nëse bën gabime të rënda, të mëdha? Jo! Çfarë



duhet të bëjë? Të ngrihet! Dhe ka një gjë shumë të bukur që do të doja t'juaja liza sot si kujtim. Alpinistët, të cilëve u pëlqen të ngjisin malet, kanë një këngë shumë të bukur që thotë kështu: “Në artin e ngjitjes - në mal - ajo që ka rëndësi nuk është të mos rrëzohesh, por të mos qëndrosh përtokë”. E bukur apo jo?!

Kush vazhdon e qëndron përtokë është “tërhequr” nga jeta, e ka mbyllur me të, nuk shpreson më, nuk dëshiron më dhe vazhdon e qëndron përtokë. Dhe kur shohim dikë, një shokun tonë që është rrëzuar, çfarë duhet të bëjmë? *Ta ngrejme atë*. A e keni vënë re kur dikush duhet të ngrejë ose duhet të ndihmojë një person të ngrihet lart se çfarë gjesti bën? E shikon nga lart-poshtë. I vetmi rast, i vetmi moment ku është legjitime ta shikosh një person tjetër nga lart-poshtë dhe kjo që ta ndihmosh të ngrihet. Sa herë, sa herë shohim njerëz që na shikojnë kështu nga lart-poshtë! Është e trishtueshme. Mënyra e vetme, e vetmja situatë ku lejohet ta shikosh një person nga lart-poshtë është... thuajeni ju..., fort: që ta ndihmosh të ngrihet.

Mirë, kjo është ecja, qëndrueshmëria në ecje. Dhe në jetë, për t'i arritur gjërat duhet që të *stërviteni* për të ecur. Ndonjëherë nuk kemi dëshirë të ecim, nuk kemi dëshirë të punojmë shumë, kopjojmë në provime sepse nuk kemi dëshirë të

studiojmë dhe nuk marrim rezultatet që duam. Nuk e di nëse ndokujt prej jush i pëlqen futbollli..., mua po. Çfarë ka pas një goli? Shumë stërvitje. Çfarë ka pas një rezultati? Shumë stërvitje. Në jetë, njeriu nuk mund të bëjë gjithmonë atë që dëshiron, por atë që thirrja që kemi përbrenda na shtyn të bëjmë dhe secili ka thirrjen e vet. Eci! Dhe nëse rrëzohem, ngrihem ose dikush do të më ndihmojë të ngrihem; mos qëndroni të rrëzuar përtokë; stërvituni, stërvituni për të ecur. E gjithë kjo është e mundur, jo sepse ndjekim një kurs për ecjen - nuk ka kurse që na mësojnë se si të ecim në jetë -: kjo gjë mësohet, mësohet nga prindërit, mësohet nga gjyshërit, mësohet nga miqtë, duke ia shtrirë dorën njërit-tjetrit. Në jetë mësohet dhe kjo është stërvitja për të ecur.

Po ju lë këto ide. Ecni dhe, nëse rrëzoheni, ngrihuni përsëri; ecni duke pasur një qëllim në jetë; ushtrohuni çdo ditë të jetës suaj. Në jetë, asgjë nuk është falas, gjithçka paguhet. Vetëm një gjë është falas: dashuria e Jezusit! Pra, me këtë dhuratë falas që kemi - dashurinë e Jezusit - dhe me dëshirën për të ecur, të ecim me shpresë, t'i shikojmë rrënjët tona dhe të ecim përpara, *pa frikë*. Mos kini frikë!

Faleminderit!
Mirupafshim!



MESAZHI I ATIT TË SHENJTË PËR DITËN E III BOTËRORE TË GJYSHËRVE DHETËMOSHUARVE

Romë, Shën Gjoni në Laterano. 23 KORRIK 2023



Të dashur vëllezër dhe motra!

“Nga breznia në brezni mëshira e tij” (Lk 1, 50): kjo është tema e Ditës së III Botërore e Gjyshërve dhe të Moshuarve. Është një temë që na kujton një takim të bekuar: atë mes vajzës Mari dhe të afërmes së saj të moshuar, Elisabetës (krh. Lk 1,39-56). Kjo, e mbushur plot me Shpirtin Shenjt, i drejtohet Nënës së Zotit me fjalë që, pas mijëvjeçarës ritmojnë lutjen tonë të përditshme: “E bekuar je mbi të gjitha gratë dhe i bekuar është fryti i barkut tënd” (v. 42). Dhe Shpirti Shenjt, tashmë i zbritur mbi Marinë, i sugjeron të përgjigjet me *Magnificat*-in, në të cilin shpall se mëshira e Zotit shtrihet nga breznia në brezni. Shpirti Shenjtë bekon dhe shoqëron çdo takim të frytshëm mes brezave të ndryshëm, ndërmjet gjyshërve dhe nipave, mes të rinjve dhe të moshuarve. Zoti, në fakt, dëshiron që, siç bëri Maria me Elizabetën, të rinjtë t'u gëzojnë zemrat e të moshuarve, e të nxjerrin urtësi nga përvojat e tyre. Por, mbi të gjitha, Zoti dëshiron që të mos lemë të moshuarit vetëm, që të mos i prangosim në periferitë e jetës, siç fatkeqësisht ndodh shumë shpesh sot.

Është e bukur, këtë vit, afërsia mes kremtimit të Ditës Botërore të Gjyshërve dhe të Moshuarve dhe ajo e Rinisë; të dyja kanë si temë "nxitimin" e Marisë (krh. v. 39) të vizitojë Elizabetën dhe kështu na shtojnë të reflektojmë mbi marrëdhëniet mes të

rinjve dhe të moshuarve. Zoti shpreson që të rinjtë, duke i takuar ata, të pranojnë thirrjen për të mbrojtur kujtesën dhe të njohin, falë tyre, dhuratën se i përkasin një historie më të madhe. Miqësia me një të moshuar ndihmon të riun që të mos sheshojë jetën e tij vetëm mbi të tanishmen dhe të kujtojë se jo gjithçka varet nga aftësitë e tij. Kurse, për më të moshuarit, prania e një të riu është hapësirë përballë shpresës se ajo që kanë jetuar nuk do të humbasë dhe se ëndrrat e tyre bëhen realitet. Me pak fjalë, vizita e Marisë tek Elizabeta dhe vetëdija se mëshira e Zotit transmetohet nga një brezni në tjetrën duke zbuluar se nuk mund të ecim përpara – dhe as të shpëtohem – vetëm, dhe që ndërhyrja e Hyjit shfaqet gjithnjë në të gjithën, në historinë e një populli. Është vetë Maria që e thotë në *Magnificat*, duke brohoritur në Hyjin që ka kryer mrekulli të reja dhe të madhërishe, besnik ndaj premtimit të bërë Abrahamit (krh. V. 51-55).

Për të kuptuar sa më mirë mënyrën e të vepruarit të Hyjit, të kujtojmë se koha duhet banuar në plotësinë e saj, sepse realitetet më të mëdha dhe ëndrrat më të bukura nuk kryhen në një çast, por nëpërmjet një rritjeje dhe një pjekurie: në ecje, në dialog, në marrëdhënie. Prandaj ai që përqëndrohet vetëm në të tanishmen, mbi arritjen e shpejtë e të etur të përfitimeve të veta, mbi “gjithçka e menjëherë”, largohet nga mënyra e të vepruarit të Hyjit. Por, projekti i Tij i dashurisë përshkon të shkuarën, të tanishmen dhe të ardhmen, përqafon dhe ndërlidh brezat. Është një projekt që shkon përtej vetes tonë, por që në të cilin çdonjëri nga ne është i rëndësishëm, dhe mbi të gjitha është i thirrur të *shkojë përtej*. Për më të rinjtë do të thotë të shkojnë përtej t menjëhershmes në të cilën na kufizon realiteti virtual, i cili shpesh të largon nga veprimi konkret; për më të moshuarit do të thotë të mos ndalen mbi fuqitë që dobësohen dhe të mos u vijë keq për rastet e humbura. Të shohim para! Të lejojmë të brumosemi prej hirit të Hyjit që, nga breznia në brezni, na çliron nga palëvizshmëria dhe nga keqardhjet e të shkuarës!

Në takimin mes Marisë dhe Elizabetës, mes të rinjve dhe të moshuarve, Zoti na dhuron të ardhmen e Tij. Ecja e Marisë dhe mikpritja e Elizabetës hapin në fakt dyert e shfaqjes së shpëtimit: nëpërmjet



përqafimit të tyre mëshira e Tij pushton me butësi të hareshme historinë e njerëzimit. Do të doja të ftoja secilin të mendonte për atë takim, dhe më shumë, të mbyllte sytë dhe të imagjinonte, si në një fotografi të çastit, atë përqafim mes Nënës së re të Zotit dhe nënës së moshuar të Shën Gjon Pagëzuesit; që të ngulitet në mendje dhe të shfaqet në zemër, për ta ngulitur në shpirt si një ikonë e shndritur e brendshme.

Ftoj më pas të kalohet në imagjinimin e përditësisë dhe të bëhet diçka për të përqafuar gjyshërit dhe të moshuarit. Mos t'i lemë vetëm, prania e tyre në familje dhe në bashkësi është e çmuar, na jep vetëdije se bashkëndajmë të njëjtën trashëgimi dhe që jemi pjesë e një populli në të cilin ruhen rrënjët. Po, janë të moshuarit që na transmetojnë përkatësinë e Popullin e shenjtë të Hyjit. Kisha, njësoj si shoqëria, ka nevojë për ata. Ata i dorëzojnë të tanishmes një të shkuar të nevojshme për të ndërtuar të ardhmen. Ti nderojmë, të mos largojmë prej vetes shoqërinë e tyre dhe të moa ua largojmë atyre shoqërinë tonë, të mos lejojmë që të hidhen tej!

Dita Botërore e Gjyshërve dhe të Moshuarve do të jetë një shenjë e vogël dhe delikate shprese për ata dhe për të gjithë Kishën. Rinovoj për këtë ftesën time për të gjithë – dioqeza, famulli, shoqata, bashkësi – t'a kremtojnë, duke vendosur në qendër gëzimin e tejmbushur të një takimi të rinuar mes të rinjve dhe të moshuarve. Juve të rinj, që po përgatiteni të niseni drejt Lisbonës ose që do të jetoni Ditën Botërore të Rinisë në vendet tuaja, do të doja t'ju thoja: para se të niseni për udhë shkoni e takoni gjyshërit, vizitoni një të moshuar që jeton vetëm! Lutja e tij do t'ju mbrojë dhe do të mbani në zemër bekimin e atij takimi. Juve të moshuar ju kërkoj të shoqëroni me lutje të rinjtë që do të kremtojnë DBR. Ata të rinj janë përgjigja e Hyjit ndaj kërkesave tuaja, fryti i asaj që keni mbjellur, shenja që Zoti nuk e braktis popullin e vet, por gjithmonë e rinon me fantazinë e Shpirtit Shenjt.

Të dashur gjyshër, të dashur vëllezër dhe motra të moshuara, bekimi i përqafimit mes Marisë dhe Elizabetës të mbërrijë te ju dhe mbushtë me paqe zemrat tuaja. Ju bekoj me mall. E ju, ju lutem, lutuni për mua



FORUMI PËR DIALOGUN DHE PAQEN NË BALLKAN

*Samiti Ndërkombëtar i Udhëheqësve të Kishave të Krishtera dhe të Feve të tjera
Koper (Slloveni), më 17 qershor 2023*

*Fjala nga Imzot Angelo Massafra në Forumin e Koperit
17. qershor 2023*



Ju jap përshëndetjen time të paqes të gjithëve ju, sipas mësimit të Jezusit dhe ju falënderoj për ftesën që më keni bërë për të bashkëndarë me ju përvojën time në shërbim të dialogut dhe të paqes.

Në fakt, sfida e paqes ishte ajo që u paraqit e para qysh në fillimet e mbarështimit tim ipeshkvnor në Shqipëri, në një kontekst lirie të rizbuluar pas diktaturës komuniste dhe për rrjedhojë edhe në një kontekst konfuzioni të madh shoqëror; por edhe në një kontekst evropian me ndryshime të mëdha dhe po aq konfuz, me konflikte të vazhdueshme dhe tensione shumë të mëdha.

Natyrisht, së bashku me shumë bashkëpunëtorë të tjerë, u vura në shërbim të kësaj kauze: duke favorizuar zgjidhjen e konflikteve të brendshme; duke kumtuar me forcë pajtimin (temë kjo që përmbahet edhe në moton time ipeshkvnore) në një kontekst të mungesës së Shtetit, që e kishte favorizuar shumë praktikën e gjakmarrjes; duke krijuar korridore humanitare për përballimin e emergjencave ndërkombëtare; duke sensibilizuar brezat e rinj për këtë çështje me çdo mjet.

Por karakteristika e veçantë e Shqipërisë që është formuar ndër shekuj është uniteti i popullit shqiptar rreth konceptit të “shqiptarisë”, herë i perceptuar në kuptimin e tij pozitiv dhe shumë herë në atë më negativ. Ky koncept ka favorizuar, nëse asgjë tjetër, të paktën mungesën e tensioneve të lidhura me përkatësinë fetare, siç ndodhi - dhe ndodh akoma - në pjesë të tjera të botës. Jo vetëm mungesë tensionesh, por një bashkëpunim të vërtetë mes besimeve të ndryshme kur bëhej fjalë për të përballuar së bashku emergjencat që shfaqeshin herë pas here.

Sot kjo “spirancë shpëtimi” e shqiptarisë, për fat të keq, rrezikon të zhduket për shkak të fenomenit të rëndë të shpopullimit, që Shqipëria po vuan në përqindje shumë të larta orë pas ore. Shqipëria po përjeton jo aq një ndryshim brezash, sesa një ndryshim kulture për shkak të një lloji “ripopullimi” nga kombësi të ndryshme që mbërrijnë dhe vendosen atje. Kjo panoramë hap skenarë të rinj nga pikëpamja sociologjike, të cilat për momentin nuk mund të hipotezohen.



Më është kërkuar që në këtë ndërhyrje të flas për problemet dhe shenjat e shpresës, por nga sa shpjegova më sipër, kuptohet se realiteti që kam hasur tridhjetë vjet më parë, kur kam mbërritur në Shqipëri, sot pothuajse është zhdukur. Ndryshojnë problematikat, sot më shumë të lidhura me sferën politike që ka nevojë për një ndryshim real, me sferën sociale për t'i bërë ballë një pabarazie të ekzagjeruar të të mirave (shpesh të arritura në mënyrë të paligjshme), që na bëjnë dëshmitarë të një pasurie të ekzagjeruar që ndodhet në duart e pak njerëzve dhe të një varfërie shumë ekstreme ende shumë të dukshme: të gjitha këto janë arsye për shqetësim, pasi mungesa e drejtësisë - siç e dimë - nuk e favorizon paqen.

Ndërhyrjet e udhëheqësve të besimeve të pranishme në Shqipëri nuk kanë munguar në këtë drejtim; në Shkodër, së bashku kemi organizuar vazhdimisht Forume për të trajtuar problematika të ndryshme, me objektivin e vetëm për të favorizuar rritjen kulturore dhe shpirtërore të popullit tonë, duke e orientuar atë drejt rrugëve të paqes.

Kohët e fundit të shumta kanë qenë rastet në të cilat e kemi gjetur veten të bashkuar në vlerat themelore: së bashku kemi mirëpritur dhe kemi reflektuar mbi mesazhin vjetor që Papa i ofron Kishës dhe mbarë botës për Ditën Botërore të Paqes; së bashku kemi trajtuar problematika që kanë të bëjnë me temën e familjes, plagën e tmerrshme të lojërave të fatit dhe të fajdeve, si dhe atë të drogave të kultivuara, të përhapura dhe të përdorura (dukuri kjo gjithnjë në rritje dhe mjaft shqetësuese!); dhe në fund edhe temën e shtëpisë sonë të përbashkët, krijimin, duke reflektuar së bashku mbi Enciklikën "Laudato si" (Ti qofsh lwvduar) të Papa Françeskut, duke botuar në dy vëllime relacionet e përgatitura. Më tej, së bashku me Myftiun e Shkodrës prezantuam online enciklikën e Papa Françeskut "Fratelli Tutti" (Vlllezwr tw gjithw). Qoftë edhe vetëm kjo punë e bërë së bashku më duket një shenjë e shkëlqyer shprese, e cila uroj që jo vetëm të vazhdojë në të ardhmen, por edhe të vlerësohet dhe të forcohet gjithnjë e më shumë.

Mesazhi im i paqes dhe i shpresës për Evropën dhe Ballkanin rrjedh nga përvoja ime tridhjetëvjeçare si udhëheqës fetar në Shqipëri, që gjithmonë ka bashkëpunuar me udhëheqës të tjerë fetarë dhe shpeshherë ka biseduar me forcat politike për t'i dhënë dinjitet njeriut kur ai është kërcënuar nga padrejtësitë.

E konsideroj thelbësore që në këtë klimë ndryshimesh të mëdha t'i dëshmojmë vlerat themelore të përbashkëta për të gjitha besimet:

është e rëndësishme që ta gjejmë veten të bashkuar rreth asaj që na bashkon, sepse shpërndarjes që po ndodh duhet t'i përgjigjemi duke ofruar pika të qarta dhe të pangatërrueshme referimi. Çdo ndarje është një humbje!

Kujtoj këtu udhëzimet bazë të Enciklikës "Pacem in Terris" (Paqja në tokë), 60-vjetorin e të cilës përkujtuam sivjet (11 prill 1963):

- Qendërzimi i personit njerëzor i pacenueshëm në të drejtat e tij.

- Universalizmi i të mirës së përbashkët.

- Themeli moral i politikës.

- Fuqia e arsyes dhe feneri i fesë.

- Papa Gjoni XXIII këmbëngul fort se paqja mes popujve ndërtohet mbi 4 shtylla: E Vërteta, Drejtësia, Dashuria dhe Liria.

Në fund, po e mbyll me thirrjen e Themeluesit të Urdhrit tim, Shën Françeskut të Asizit, të cilit i pëlqente t'u përsëriste fetërve të tij: "*Paqen që shpallni me gojë, uroj që ta keni edhe më të bollshme në zemrat tuaja*".





FORUMI PËR DIALOGUN DHE PAQEN NË BALLKAN

*Samiti Ndërkombëtar i Udhëheqësve të Kishave të Krishtera dhe të Feve të tjera
Koper (Slloveni), më 17 qershor 2023*

Paqja me ty, Evropë – Paqja me ty, Ballkan / Pax tibi, Europe - Pax tibi, Ballkan



Deklarata përfundimtare

«Për dashuri ndaj vëllezërve e miqve të mi do të them: "Paqja me ty!"» (Ps 122,8)

Që nga fillimi i shekullit të 21-të, Evropa po përballet edhe një herë me një sërë sprovash: lufta në Ukrainë, kriza në fusha të ndryshme dhe një tjetërsim i përgjithshëm mes njerëzve, që po shkaktojnë mungesë shprese në të ardhmen. Parashikimet optimiste rreth kohezionit evropian dhe global, bazuar në një konceptim laik perëndimor të njeriut dhe të shoqërisë, kanë rezultuar të kufizuara. Me gjithë vështirësitë e çdo periudhe historike, ekzistojnë mundësi dhe vende në udhëkryq të mjediseve të ndryshme kulturore, që lejojnë takimin dhe dialogun, veçanërisht mes udhëheqësve fetarë, të cilët janë të parët që thirren për të parë përtej axhendave politike dhe axhendave të tjera kalimtare, edhe pse vazhdojnë të qëndrojnë në kontakt me të këqijat e kësaj bote. Një vend i tillë është Sllovenia, e vendosur në "Zemër të Evropës", midis Alpeve, Mesdheut dhe Panonisë (Hungarisë), e cila mund të shërbejë si një urë lidhëse mes botës sllave, gjermanike dhe neolatine. Kjo reflektohet veçanërisht në qytetin bregdetar të Koperit, i cili,

për shkak të pozicionit të tij gjeografik dhe të përvojës historike, lidh Mesdheun Lindor dhe Perëndimor dhe rrjedhimisht degët lindore dhe perëndimore të krishterimit dhe të traditave të tjera fetare.

Ne relatorët në "Forum për dialogun dhe paqen në Ballkan" jemi të vetëdijshëm për nevojën dhe detyrën për të promovuar respektin e ndërsjellë dhe bashkëjetesën paqësore mes anëtarëve të traditave të ndryshme fetare, etnike dhe të grupeve të tjera, siç konfirmojnë shembujt e shumtë pozitivë të përvojës komplekse dhe të vështirë historike të kësaj zone gjeografike. Kemi arritur një qëndrim të përbashkët dhe deklarojmë përfundimet e mëposhtme:

1) Në rrethana të paqëndrueshme, Feja në Hyjin, i cili i përmbush premtimet e veta (krh. 2Kor 1,18), mund të jetë një mbështetje për të ngulmuar në mirësi në sferën ndërpersonale, shoqërore dhe shpirtërore. Për këtë arsye, udhëheqësve fetarë dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë u hapet perspektiva e përjetshme, e cila sheh në rrethanat dhe në të mirat kalimtare të kësaj bote vetëm një mjet, jo një qëllim, për plotësinë e jetës këtu dhe në jetën e ardhshme.



2) Rrënja në traditën shpirtërore u jep të krishterëve dhe anëtarëve të feve të tjera sensin e qëllimit dhe të përgjegjësisë për të konkurruar për një imazh holistik të personit njerëzor dhe për një zhvillim të ekuilibruar shoqëror. Është mbi të gjitha një dialog që promovon ushtrimin e lirisë fetare dhe favorizon një kujdes të qëndrueshëm ndaj burimeve natyrore dhe një zhvillim ekonomik, që e vendos në qendër mirëqenien e personit dhe të bashkësisë, në vend që t'i nënshtrohet rritjes apo përfitimit të pakufizuar. Në këtë kontekst, duhet të promovohet gjithnjë e më shumë vizioni i një "ekologjie të vëllazërisë njerëzore", siç tregohet në enciklikën e Papa Françeskut "Vëllezër të gjithë" (2020).

3) Arritja e drejtësisë, si në aspektin ekologjik, ashtu edhe atë politiko-ekonomik, kontribuon bindshëm në promovimin e paqes në Ballkanin Perëndimor sot dhe nesër.

4) Si njerëz të fesë, jemi të lidhur nga urtësia ungjillore "Lum pajtuesit" (Mt 5,9) dhe nga mesazhi i paqes së Profetëve të shenjtë, objektivi ynë i përbashkët është një paqe që është "fryti i drejtësisë" (Is 32,17). U bëjmë thirrje të gjithë njerëzve vullnetmirë, veçanërisht atyre që kanë autoritetin që të promovojnë kryesisht dialogun dhe paqen gjithë kohën.

5) Bazuar në angazhimin e tyre për dialogun dhe për ofrimin e ndihmave humanitare për të gjithë njerëzit e prekur, pa asnjë dallim, bashkësitë fetare duhet të jenë të vetëdijshme për kompleksitetin e situatës aktuale, duke theksuar kështu gatishmërinë e tyre për të qenë të pavarura nga interesa politike apo të ndonjë lloji tjetër kalimtar.

6) Në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në vendet e tjera, e drejta e ekzistencës së të gjitha bashkësive fetare duhet të njihet qartë dhe autoritetet shtetërore duhet të ftohen të respektojnë lirinë e tyre në interes të paqes dhe të dialogut.

7) Ekstremizmi, terrorizmi dhe çdo formë tjetër dhune apo lufte nuk kanë asnjë lidhje me fenë e vërtetë dhe duhen refuzuar si në shoqëri, ashtu edhe në nivelin e vetë bashkësive fetare.

8) Në dekadat e fundit, vendeve të Gadishullit Ballkanik u është dashur të përballen edhe me një problem demografik, me të cilin është e lidhur ngushtë çështja e emigrimit ekonomik. Është një pyetje e shumëanshme – morale dhe shpirtërore – që kërkon, ndër të tjera, një reflektim kritik mbi veprimet e kaluara nga udhëheqësit politikë, ekonomikë dhe fetarë.

9) Ka një rëndësi të madhe që bashkësitë e ndryshme fetare të Ballkanit të takohen rregullisht dhe të kërkojnë zgjidhje të përbashkëta, ku Kisha Katolike, Kisha Ortodokse dhe Bashkësia Islame kanë një përgjegjësi të veçantë për shkak të ndikimit të tyre historik dhe aktual.

Nuk mund të ketë një takim të singertë dhe një dialog të frytshëm pa lutjen dhe pa besimin te Krijuesi, i cili është zoti i historisë dhe përfundon atë që njeriu nuk mund ta bëjë i vetëm.

Vetëm një fe e përforcuar në Hyjin dhe një vlerësim i singertë i veprimeve tona të kaluara, të shënuara nga pafuqia njerëzore, ndihmojnë arritjen e paqes dhe të begatisë në sferën e marrëdhënieve personale, shoqërore dhe shpirtërore.



Moter Marjeta Gjoka

Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta

KISHA SI «MISHËRIM» I LIRISË DHE BESNIKËSISË

«Kush ka veshë, le të dëgjojë çka Shpirti Shenjt u thotë Kishave!» (Zb 2, 11).



Kisha mbi të gjitha është mister dhe është trupi mistik i Krishtit, është nusja e Fjalës së mishëruar. Kisha është vendi ku të gjitha fertilitetet e mishërimit realizohen sipas mendimit të Atit, i cili e dërgoi në botë të Birin si shpëtimtar dhe misioni i Tij përmbushet në historinë e botës. Është për realitetin e Kishës që historia e njerëzimit bëhet histori shpëtimit. Ne të Krishterëve na duhet vazhdimisht të lihem i shndritëmi nga mësimi i magjisterit të Kishës, duke u kujtuar gjithmonë që Kisha është mister, është ngjarja që Zoti përmbush nëpërmjet shpëtimit. Jemi mësuar ta konsiderojmë Kishën si një realitet njerëzor, duke lënë pas dore realitetin më suprem që është ai shpirtëror. Është e vërtetë që ne jemi gjymtyrë të Kishës, por është edhe e vërtetë që jemi të pirur të mendojmë që gjërat me të rëndësishme të Kishës janë njerëzit me historitë e tyre. Kisha para se të jetë njerëzore është hyjnore, para se të jetë e formuar nga njerëzit është e formuar nga një njeri që është Biri i Zotit nga i gjithë amshimi. Ajo është e thirrur të jetë dhe të bëhet një «mishërim»

gjithnjë e më e mirë e lirisë dhe e besnikësisë nëpër të cilat Krishti na liroi. Zoti e thirri atë nga asgjëja me lirinë e saj të aftë për të dashur dhe krijuar gjëra të reja.

Kisha nuk duhet të duket kurrë si një skllave, ku bijtë janë në zinxhirë. Ajo është gruaja e lindur e lirë, nusja e Krishtit i cili është Çlirimtari, liria e mishëruar. Sepse është shkruar se Abrahami kishte dy djem, një nga skllavja e tij dhe tjetri nga gruaja e tij i lindur i lirë. Djali i të robëruarës lindi sipas rrjedhës së natyrës; djali i gruas së lirë për shkak të premtimit hyjnor. Kjo është një alegori, ku gratë përfaqësojnë dy besëlidhjet... E para lind fëmijë për skllavëri... Por Jeruzalemi qiellor është gruaja e lirë, ajo është nëna jonë (krh. Gal 4, 22-26).

Është e lehtë por edhe e vështirë të duash Kishën të parë në këtë thirrje themelore. Ne vlerësojmë gjithçka në Kishë që është besnike ndaj kësaj thirrjeje dhe vuajmë sa herë e shohim të dështojë. Natyrisht, duke thënë «Kishë» duhet para së gjithash të shikojmë veten dhe të gjykojmë



veten nëse po japim një kontribut «të mishëruar» në rritjen e Kishës në thirrjen e saj për të qenë përgjigja e lirë dhe e «mishëruar» ndaj Krishtit i cili na çliroi. E megjithatë ne nuk mund të mos merremi edhe me kishën-institucion.

Kisha duhet të jetë një bashkësi njerëzish të çliruar dhe të përkushtuar për çlirimin e të gjithëve, në përgjigje të aspiratës së gjithë krijimit për të marrë pjesë në lirinë e bijve të Hyjit, duhet të jetë një sakrament i historisë së çlirimit, duhet të kremtojë dashurinë çlirimtare të Hyjit në liturgji dhe në jetë, duke kujtuar të gjitha ngjarjet në të cilat ajo i është përgjigjur me të vërtetë thirrjes së tij dhe gjithashtu duke kujtuar me pendim dhe përlulësi, shumë raste në të cilat ka dështuar. Thirrja e tij është të jetë një bashkësi që zhvillon një vizion profetik të të gjitha mundësive të pranishme për t'i shërbyer çështjes së lirisë, në besnikëri ndaj Hyjit të historisë, një bashkësi që në përkujtimin e Hyjit kremton shpresën e çlirimit përfundimtar dhe që më pas ai i përkushtohet gjithnjë e më shumë detyrës së tij.

Qëndrimi themelor që duhet të shkëlqejë gjatë gjithë jetës së Kishës dhe veçanërisht në kremtimin e saj liturgjik, duhet të jetë ai i një kujtimi mirënjohës që lavdëron dhe falënderon Hyjin që na dërgoi Jezu Krishtin për të na liruar dhe Shpirtin e Shenjtë, nëpërmjet të cilit ne jemi në gjendje të jetojmë në mënyrë krijuese në liri dhe besnikëri. Kisha u tërhoq nga një botë që ka shumë kushte dhe shërbime. Është e thirrur për liri, por duke qenë e përbërë nga njerëz, liria e të cilëve shpesh errësohet dhe bllokohet nga skllavëria e pushtetit dhe e gënjeshtrave. Për këtë i krishteri duhet të rrijë zgjuar dhe të ketë kujdes të veçantë të mos tërhiqet nga një liri e shthurur por të jetojë në lirinë dhe me lirinë e bijve të Hyjit. Kur ai gabon dhe bie pre e skllavërisë së mëkatit duhet të kujtohet që nuk ka rrugë drejt lirisë së ardhshme pa pendim. Nuk mund të harrojmë që e kaluara ka zënë rrënjë në të gjithë realitetin njerëzor dhe është një akt lirie për ta sjellë këtë në një nivel të ndërgjegjshëm dhe për të shqyrtuar idetë tona aktuale (krh. Karl Rahner, fjalor enciklopedik i *teologjisë morale*, ed. Paoline, Romë 1976).

Kisha sakramenti i pranisë së Krishtit

Kisha është e dukshme dhe në dukshmërinë e saj ajo i bën një shërbim padukshmërisë së Krishtit ashtu siç i bën një shërbim besimit tonë, i cili duhet ta ndiejë Krishtin afër dhe duhet të dijë se Krishti është besnik ndaj premtimeve të tij, «Unë do jem me ju gjithmonë - deri në të sosur të botës!» (Mt 28, 20). Kisha është sakrament i

pranisë së Krishtit në zemrën e besimtarit dhe në zemrën e botës, është vetë Kisha që shpjegon e shfaq gjallërinë dhe frytshmërinë e saj nëpërmjet gjeesteve sakramentale.

A është e vërtetë që Krishti më arrin me faljen e tij? A nuk është e vërtetë që Krishti më ofron veten si bukë e jetës dhe si bukë e jetës së përjetshme? A nuk është e vërtetë që prania e tij në jetën time bëhet burimi i një bamirësie dhe një bashkimi që përhapet në të gjitha drejtimit?

Ky është sakramentaliteti i Kishës dhe kjo duhet të na bëjë të kuptojmë shumë më mirë se sa e vërtetë është që jeta sakramentale e individit nuk është gjë tjetër veçse manifestimi i jetës së mbinatyrshme të Kishës, trupi mistik i Zotit dhe sakramenti i shpëtimit.

Kisha është bashkësi

Për faktin që Kisha është Mister dhe Kisha është Sakrament lejojmë që frytshmëria e mishërimit të rrjedhë në jetën tonë, Kisha është gjithashtu diçka tjetër, është ajo ngjarje e bashkimit universal për të cilën përkufizimi më i përshtatshëm i Kishës është ai i «njerëzve të Hyjit», i «bashkimit të njerëzve në Krishtin Jezus». Besimi ynë ka nevojë të ndriçohet. Kisha na thërret, Kisha na bashkon me Krishtin Zot, ne bëhemi një me të dhe duke u bërë një me të bëhemi një me njëri-tjetrin, prandaj Kisha është një bashkësi.

Të jesh Kishë nuk do të thotë vetëm të jetosh një marrëdhënie veçanërisht të thellë dhe jetëdhënëse me Krishtin Jezus, por do të thotë gjithashtu të shumëfishosh marrëdhëniet me të gjitha krijesat që Krishti i thërret në shpëtim dhe i thërret në shëlbimin e tij të mrekullueshëm.

Ne jemi Kishë në masën që jemi të bashkuar, jemi Kishë në masën që bëjmë bashkim ky është përkufizimi i Kishës dhe është një bashkësi në progres, bashkimi ynë kishtar është një bashkësi që nuk ndalet kurrë së përparuari. Nuk pushon së thelluari dhe që na bën shtegtarë drejt Absolutit dhe drejt amshimit që është qielli, ku bashkësia në Zotin e të gjithë të bekuarve do të jetë burimi i lavdisë dhe gëzimit të përjetshëm (Krh. A. Ballestrero, *Silenzi e stupore*).

Kisha shenjë ndriçuese për të gjithë popujt

Respektimi i ndërgjegjes së drejtë i lirisë fetare dhe tolerancës nuk duhet të jetë çështje taktike në jetën kishtarë, përkundrazi ato duhet të kuptohen si një kërkesë thelbësore e Kishës, në mënyrë që ajo të mundet të ngrihet mes të gjithë popujve dhe kombeve si një shenjë ndriçuese e



lirisë së «mishëruar» dhe si një thirrje për besnikëri dhe krijimtari në punë e në veçanti për një liri gjithnjë në rritje në brendësinë e botës.

Përpyekjet edukative të Kishës duhet t'i drejtohen veçanërisht inteligjencës së duhur dhe «mishërimit» të duhur të lirisë, besnikërisë dhe veprimit krijues. Kisha duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje shërbesës profetike krahas shërbimit meshtarak. Duhet të kuptojmë se Zoti mund të thërrasë profetë jo vetëm nga radhët e atyre që mbajnë poste, por edhe nga besimtarët që as nuk e mendojmë. «Mishërimi» i Kishës i lirisë dhe besnikërisë dhe roli profetik i besimtarëve në botën laike për rritjen e lirisë dhe dallimin midis lirisë së vërtetë dhe besnikërisë së vërtetë dhe falsifikimeve të tyre është «një terren ku mbretëria e Hyjit vihet në provë» (Krh. J. Moltmann, *Theology of play*, New York 1972, 58-61).

Qëndrimi i Kishës ndaj lirisë në jetën dhe strukturat e saj dhe përkushtimi i saj ndaj lirisë në botën laike janë një provë e besimit të saj në Krishtin që erdhi për të na çliruar dhe e besimit të saj në frymëzimin e Shpirtit Shenjtë. Tundimi për të ndërtuar shumë llogore dhe kontrole, për të vënë theksin e tepërt në një sistem ndëshkimesh dhe shpërblimesh vjen nga mungesa e besimit në Shpirtin Shenjtë. Sa herë që Kisha vendos kufizime për lirinë dhe besnikërinë krijuese, ajo duhet të jetë në gjendje të provojë se kjo bëhet vetëm për hir të vetë lirisë domethënë për të krijuar kushte të favorshme për rritjen e saj në çdo vend dhe për të gjithë njerëzit. Në masën që Kisha

është në gjendje të festojë drejt një historie të kaluar besnikërie dhe çlirimi, të nxjerrë në dritë gabimet dhe lëshimet e saj të së shkuarës në një rit falënderimi shpirtëror për fuqinë përtëritëse të Hyjit dhe të zbulojë mundësitë e pranishme në besnikërinë dhe krijimtarinë përgjegjëse, është një bashkësi eskatologjike që parashikon të ardhmen e gjithë njerëzimit (Krh. W. Pannenberg, *Theology of the kingdom*, Philadelphia 1969, 75).

E hapur ndaj Shpirtit, ajo do t'i hapet zërit të profetëve duke dëgjuar zërat provokues të profetëve dhe thirrjen e vet profetike. Atëherë ajo do të jetë në gjendje të sigurojë kritere për dallimin midis çlirimit të vërtetë dhe të rremë, fjalët nuk do të mjaftojnë kurrë. Liria dhe besnikëria krijuese duhet të mishërohen në të gjitha strukturat e Kishës, në të gjithë vizionin dhe mësimet e saj, duke përfshirë liturgjinë.

Duke qenë në Kishë na ndihmon të kuptojmë se ne jemi imazhi i saj e duhet të mbajmë këtë imazh me dinjitet. E ne e dimë mirë se jemi gjymtyrë të Krishtit dhe Krishti është imazh i Trinisë në botë, e ne që jemi gjymtyrë të Krishtit dhe imazh i Kishës duhet të jemi një njerëzim i ndriçuar, sepse këta janë karakteristikat e popullit të Hyjit. «Ky popull, anëtarë të të cilit bëhemi me anë të fesë në Krishtin dhe të pagëzimit, ka si *zanafillë* Hyjin Atë, si *krye* Jezu Krishtin, si *kusht* dinjitetin dhe lirinë e bijve të Hyjit, si *ligj* urdhrin e ri të dashurisë, si *mission* të qenët kripa e tokës dhe drita e botës, si *qellim* Mbretërinë e Hyjit, tashmë të filluar në tokë» (Katekizmi i Kishës Katolike, *përmbledhje*, n 154).



Motër Dila Shtjefni

Françeskane e Zojës së Papërlyer

PERSPEKTIVA E TË NGRITURIT TË VIRGJËRËS MARI NË QIELL DUKE U NISUR NGA NGJALLJA E Jezu KRISHTIT



Për të kuptuar të ngriturit e Virgjërës Mari në qiell dhe dimensionin eskatologjik të saj, sigurisht duhet të nisemi nga ngjallja e Jezu Krishtit, ngjarja kryesore dhe thelbësore e krishtërit, pa të cilën feja e krishterë do të ishte e kotë (1Kor 15,14) (EV, vol. 13, nr. 448). Ky fakt bën pjesë në horizontin eskatologjik të shpresës i cili cilësohet si ngjarje e lidhur me kohët e fundit (F. MANZI, Trattati mariologici del “vangelo” di Paolo, in Theotokos 8 [2000] nr. 2, ff. 649-569). Trupi i ngjallur i Krishtit është i njëjti, ai i cili ka qenë kryqëzuar (krh. N. CIOLA, Gesù Cristo Figlio di Dio I. Vicenda storica e sviluppo della tradizione ecclesiale, Borla, Roma 2012, fq. 354; N.T. WRIGHT, Risurrezione, Claudiana, Torino 2006, fq. 804; X. LÉON-DUFOUR, Risurrezione di Gesù e messaggio pasquale, Paoline, Cinisello Balsamo 19872, fq. 49), por nuk i përket më kësaj bote, prandaj edhe nuk është menjëherë i identifikueshëm, sikurse shihet në tregimin e Ungjillit të Gjonit (krh. Gjn 20).

Të ngjallurit e Tij nuk do të thotë një kthim në jetën e mëparshme (krh. W. KASPER, Gesù il Cristo, Queriniana, Brescia 1991, ff. 196-197), sikurse pohon shën Pali: «mbasi e dimë se Krishti i ngjallur nga të vdekurit, nuk vdes më: vdekja nuk ka më pushtet mbi të» (Rom 6,9). Këtu Kasper saktëson se ngjallja e Krishtit nuk është vetëm vepër eskatologjike dhe përfundimtare e Hyjit, por edhe vetëzbulues e pranisë së Tij dhe e veprës së Tij në kohën e fundit. Në të shfaqet, në mënyrë definitive dhe të patejkalueshme, kush është realisht Hyji, dhe si është Ai të cilit mund t'i besohet pa hezituar.

Ngjallje nuk do të thotë të rimarrësh mënyrën e vjetër të të jetuarit, por, na ofron bazat e ekzistencës

së qytetit qiellor, «pikarritje e ekzistencës njerëzore» (S. DE FIORES, L'Assunzione di Maria secondo La Pira: contesto, struttura, contenuti, f. 115). Vazhdimësia e identitetit në mes të Kryqëzuarit dhe të Ngjallurit qëndron ekskluzivisht në besnikërinë krijuese e në besëlidhjen e Hyjit. Kështu, nuk mund të krahasohet as nuk mund të pranohet ndonjë analogji me ngjarje tjera, prandaj historia ka marrë një kahje tjetër. Në lidhje me këtë, W. Kasper pohon se:

«ngjallja e Jezusit mund të cilësohet si një ngjarje në të cilën gërshetohen dy elemente, ai historik e ai teologjik-eskatologjik. Ngjallja e Jezusit përmban dimensionin e saj historik në faktin se ajo realizohet në Jezusin e Nazaretit i cili ka qenë kryqëzuar. Ngjallja e Jezusit domethënë se kryqi përbën, nga pikëpamja njerëzore, mbarimin, dështimin, çnderimin, por në të njëjtën kohë edhe se është një vepër e pushtetit hyjnor e prandaj përbën një fillim të ri dhe një motiv shprese» (W. KASPER, Gesù il Cristo, f. 205).

Nëse trupi i Jezusit të Nazaretit ka qenë përfshirë plotësisht nga Ngjallja e tij e lavdishme, ne që besojmë në të kemi shpresë që kjo do të na ndodhë edhe neve. Prandaj, ngjallja, si ngjarje eskatologjike, përbën shtrirjen dhe ndikimin mbi njeriun dhe mbi kozmosin i asaj që është përmbyshur “njëherë e përgjithmonë” në të vetmin *eschaton* të Krishtit. Ngjallja e të vdekurve i referohet shëlbimit të njeriut në plotësi, domethënë krejtësisht dhe i pandarë e jo vetëm i shpirtit. Nga Krishti i ngjallur, i krishteri pranon mundësinë që të mund të marrë formën që të



jetë në gjendje të pranojë dhuratën e ngjalljes nga të vdekurit, sepse Krishti jo vetëm që është ngjallur, por Ai është edhe e mbi të gjitha «Ringjallja dhe jeta» (*Gjn*11,25), duke u bërë edhe shpresa e ringjalljes sonë (krh. Komisioni Teologjik *Internacional, probleme aktuale të eskatologjisë*, në EV, vol. 13, nr. 461, ff. 272-273).

Shën Pali na jep garancinë e ringjalljes dhe e sqaron këtë gjendje kështu: «nëse Shpirti i Atij që e ngjalli nga të vdekurit Jezusin banon në ju, atëherë Ai që e ngjalli Krishtin prej të vdekurve, do t'i japë jetë edhe trupit tuaj të vdekshëm me anë të Shpirtit të vet që banon në ju» (*Rom* 8,11). Ngjallja është, gjithashtu, forma e trupit të lavdishëm të cilin Hyji e ka menduar për secilin prej nesh. Nëse mendojmë gjendjen përfundimtare të ekzistencës së Marisë Virgjër të lavdishme, ajo paraqitet gjatë historisë në perceptime të ndryshme: në përshkrimin perëndimor shihet nëpërmjet figurës së saj që *ngritët* në qiell e shoqëruar nga engjëjt; kurse në ikonat bizantine paraqitet *Panaghia* e shtrirë në shtratin e vdekjes, ndërsa Zoti Jezus pranon në krahët e tij shpirtin e saj.

Një pikë referimi biblik për shpjegimin e gjendjes së lavdishme të Marisë është gjendja e trupave pas ringjalljes së përshkruar nga Shën Pali në letrën e parë drejtuar Korintasve. Edhe pse duke pranuar një farë vazhdimësie midis trupit të vdekshëm dhe atij të ringjallur, Apostulli këmbëngul

mbi ndryshueshmërinë e tyre nëpërmjet disa antitezave: «Kështu edhe ngjallja e të vdekurve mbillet në shkatërrueshmëri e ngjallet në pashkatërrueshmëri; mbillet në çnderim e ngjallet në lavdi; mbillet në dobësi e ngjallet në fuqi; mbillet trup lëndor e ngjallet trup shpirtëror» (*1Kor* 15,42-44).

Duke ia aplikuar këtë doktrinë Marisë së ngritur në qiell, duhet t'i njihet trupit të saj pashkatërrueshmëria, që tregon fitoren mbi vdekje e mbi prishjen në varr, sepse është rrënjësisht e shndërruar në ngjalljen e Krishtit. Duke thelluar këtë perspektivë të trupit të lavdishëm, “pneumatik”, S. De Fiores e përshkruan trupin e Nënës së Jezusit, sikurse atë të Birit, i lirë nga ligjet e materies, të kohës e të hapësirës (khr. *Gjn* 20,19-26) në sajë të veprës së Shpirtit Shenjt që është për të gjithë «Shpirti që jep jetën» (*1Kor* 15,45). Kjo do të thotë se Virgjra e shenjtë e plazmuar dhe e shndërruar nga Shpirti Shenjt është vënë në gjendje, deri në Parusi, të ushtrojë amësinë e saj shpirtërore ndaj dishepujve të shëlbuar e të dashur nga Jezusi Biri i saj e Zot (krh. *Gjn* 19.25-27).

Ngjallja dhe të Ngriturit e Virgjres Mari në qiell akt eskatologjik unik

Duke analizuar disa reflektime të personazheve që kanë besuar në këtë mister, tregohet se dogma eskatologjike-mariane ka ndikuar në favor të trupave



tokësorë të vuajtur, por të përcaktuar për pashkatërrueshmëri dhe për lavdi të pavdekshme. Ky projektim eskatologjik, si fati i përjetshëm i njeriut dhe i kozmosit, përbën një nxitje për një angazhim më të madh në shërbim të të tjerëve në shpirt agapik të Ungjillit të Jezu Krishtit. Të ngriturit e Nënës së të Ngjallurit në qiell nuk duhet të shihet si një përjashtim, një privilegj i jashtëzakonshëm, por si shembull, sepse Maria u paraprin të krishterëve duke parashijuar në vetvete fatin e tyre të fundit (G. CALVO MORALEJO-S. CECCHIN (a cura di), *L'Assunzione di Maria Madre di Dio*, fq. 685). Në Marinë hershohet fati i të drejtëve që qëndrojnë në besnikëri ndaj Zotit e në mënyrë të tillë ajo paraqet shpresën e krishterë.

Kështu, për të njohur figurën e Marisë dhe funksionin e saj në historinë e shëlbimit, si edhe praninë e saj të gjallë në Kishë, nuk duhet të ndalemi vetëm në fazën e jetës së saj tokësore, por është e nevojshme të vazhdohet deri në të ngriturit e saj në qiell, në *statusin* e glorifikimit. Varfëria e “shërbëtores” duhet të shihet në perspektivën e plotësisë eskatologjike të “mbretëreshës” (në kuptimin biblik) e shëlbuar në mënyrën më të përsosur nga Krishti dhe pjesëmarrëse me Shpirtin Shenjt në dhënien e jetës.

Në mariologjinë e tij S. De Fiores përpiket të ekuilibrojë dhe të bashkojë jetën tokësore me jetën qiellore të Marisë, duke treguar se dendësia historike e prania aktuale nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën por paraqesin një reference reciproke. Lidhja në mes mariologjisë dhe eskatologjisë është vërtetesh e ngushtë. Për Kishën që është në ecje drejt *eschaton*, Virgjra e ngritur në qiell është figurë e pastër e asaj që ajo dëshiron dhe shpreson të jetë në të gjitha gjymtyrët; përkundrazi ajo është fryti i parë, tashmë i realizuar e i përsosur. Në fakt «Kisha në të lumen Virgjër ka arritur tashmë përsosmërinë që e bën të panjollë e të parrudhë» (krh. *Ef* 5, 27); është shenja e shpresës së sigurte dhe e ngushëllimit në dritën e të cilit populli i Hyjit përmbush udhëtimin derisa të vijë dita e Zotit.

Virgjra Mari, ndërsa na ndihmon të reflektojmë mbi gjithë konkretësinë e mishërimit të Krishtit, i cili është fakti universal i çlirimit të çdo njeriu (krh. *1Kor* 15,20-25), në të njëjtën kohë ajo, e lavdëruar në qiell me trup e me shpirt, është shëmbëllesë dhe fillim i Kishës që do të duhet të ketë përmbushjen e saj në kohën e ardhme. Virgjra, në figurën e saj plotësisht njerëzore, na bën të kuptojmë që për çdo njeri jo vetëm është e mundur por e domosdoshme t'i përkasim Krishtit për të bashkëpunuar në veprën e shëlbimit të të gjithë njerëzimit, vepër që shtrihet drejt arritjes së Mbretërisë që do të realizohet

plotësisht në fundin e kohëve, por se që tani ka filluar inaugurimin (*Lk* 17,20-21). Kjo bën të kuptojmë se dimensionin eskatologjik i Kishës nuk është thjesht një ndër elementet e krishterimit por është, në kuptimin e plotë, konkretizimi i fundit i fesë, e cila duhet t'i japë arsye çdo situatë ekzistenciale aktuale.

Feja, në fakt, jeton nga ngjallja e Krishtit të kryqëzuar (*1Kor* 15,1-11) dhe vazhdon drejt premtimeve të ardhshme. Eskatologjia e krishterë nuk flet për një të ardhme në përgjithësi, por nxitet nga një realitet historik i përcaktuar dhe shpall mundësinë për të pasur një të ardhme, edhe përtej çdo parashikimi, dhe për këtë lufton. Të gjitha ngjarjet e misterit në të cilin Maria është e pranishme, na mësojnë ne të krishterëve se edhe pse me shpresë marrim pjesë në lirim dhe glorifikimin e saj, megjithatë jetojmë akoma në fazën e nënshtimit ndaj ngjarjeve të historisë, derisa të vijë dita e Zotit (krh. *2Pjt* 3,10), (krh. PONTIFICIA ACADEMIA MARIANA INTERNATIONALIS, *La Madre del Signore*, nr. 19, ff. 26-27). Të ngriturit e Marisë Virgjër në qiell bëhet kështu një shenjë shprese, sepse është ngjarje që i përket historisë së shëlbimit, dhuratë e Hyjit e shenjë e hirit për Kishën dhe për njerëzit e kohës sonë.

Nuk duhet të harrojmë se edhe të vërtetat dogmatike mbi Nënë e Jezusit vënë në dukje bujarinë dhe gjithpushtetësinë e Hyjit të vetëm trinitar i cili dëshiron të na dhurojë të mirat e Tij për shëlbimin tonë. Pra, të flasësh për Marinë do të thotë t'i referohesh Hyjit dhe njeriut: Hyjit sepse Nëna e Shëlbuesit është krijesë në marrëdhënie me Hyjin Atë, Bir dhe Shpirt Shenjt e njeriut sepse vetëkuptohet në Marinë, si e Papërlyer dhe e Ngritur në qiell, domethënë është ikonë protologjike dhe eskatologjike. Përveç kësaj, fillimi dhe mbarimi i ekzistencës së saj shembullore historike e teologale, hedhin dritë mbi thirrjen tonë në shenjtëri dhe përmbushjen përfundimtare dhe të amshuar drejt së cilës me anë të *Hirit*, zgjatemi me shpresë të ngultë se Hyji është besnik në premtimet e veta.

Si gjymtyrë e shkëlqyer e Kishës, Virgjra Nënë është prani e gjallë dhe një ekzistencë plot me Shpirtin Shenjt, ashtu sikurse na e paraqet Besëlidhja e Re në mes dy ngjarjeve historiko-shëlbese: *fillestare* (krh. *Lk* 1,26-38) e *përfundimtare* (krh. *At* 1,14).

Nga këto mund të pohohet se në mariologji lidhen linjat kristologjike, pneumatologjike, ekleziologjike, antropologjike dhe eskatologjike, duke u zbuluar si pikë takimi e mistereve më të rëndësishme teologjike. Pra nëse do të kuptohej në këtë mënyrë Maria, Nëna e Hyjit do të përbënte një pasuri edhe për fushat e ndryshme të teologjisë.



ARQIDIOQEZA SHKODËR-PULT

† Angelo Massafra O.F.M.

Prot. N. 95/2023

Shkodër, 12/08/2023

Lënda: Muaj Shtator: muaj lutje për botën e krijuar

Shkëlqesi Ipeshkvij,
Meshtarë, Rregulltarë dhe Rregulltare
dhe, përmes jush,
të gjithë besimtarëve laikë të Kishës së shenjtë që është në Shqipëri
ju mbërrifitë përshëndetja ime e paqes në Zotin Jezus.

Sërish këtë vit kremtojmë takimin e bukur, që i përgjigjet dëshirës së Papa Françeskut për ta përjetuar në një dimension ekumenik Kohën e Krijimit, kohë e cila zgjat nga dita e parë e shtatorit deri më 4 tetor, që është edhe festa liturgjike e Shën Françeskut të Asizit, vëllait universal.

Vitin e kaluar ne Ipeshkvijtë kemi paraqitur qëllimin tonë për të qenë në përputhje me Kishën universale, në bashkim me Kishat e tjera të krishtera, që në mbarë botën e kremtojnë këtë ditë lutjeje dhe këtë kohë ndërgjegjësimi.

Po ju paraqes disa propozime që do t'i gjeni bashkangjitur kësaj letre dhe ato janë:

- Mesazhi i Atit të Shenjtë Françesku për këtë Ditë Botërore.
- Poster i Ditës në format PDF për t'u printuar dhe për ta përdorur secili për realitetet e veta lokale ose rrjetet sociale.
- Një material për gjallërimin liturgjik të bashkësive tona që përmban disa fjalë kyç, nxitje për homelinë dhe lutjet e besimtarëve, material ky do të përdoret gjatë pesë të dielave, duke filluar nga e diela 3 shtator.
- Një Vigjilje lutjeje ekumenike, që do të përdoret lirisht gjatë kësaj kohe, me ose pa Kisha të tjera të krishtera në zonën tuaj.

Në Mesazhin e tij, Papa Françesku na fton që ta dëgjojmë *“thirrjen për t'u qëndruar pranë viktimave të padrejtësisë mjedisore dhe klimatike, si dhe për t'i dhënë fund kësaj lufte të pakuptimtë kundër krijimit”*.

Në këtë kuptim, Ati i Shenjtë propozon *“t'i shndërrojmë zemrat tona, stilet tona të jetesës dhe politikat publike që drejojnë shoqëritë tona”*. Për këtë qëllim, ai kujton se Shën Gjon Pali II na nxiti të jetonim *“kthimin ekologjik”*, që konsiston në ripërtëritjen *“e marrëdhënies sonë me krijimin, që të mos e konsiderojmë më si objekt për ta shfrytëzuar, por përkundrazi, ta ruajmë si dhuratë të shenjtë nga Krijuesi”*.

“Duhet t'i shndërrojmë politikat publike, që drejojnë shoqëritë tona dhe formësojnë jetën e të rinjve të sotëm dhe të nesërm”, nxiti Papa Françesku.

Në fund, Ati i Shenjtë thekson rëndësinë e sinodalitetit dhe shpreson *“që në këtë Kohë të Krijimit, si ndjekës të Krishtit në rrugëtimin tonë të përbashkët sinodal, të jetojmë, të punojmë dhe të lutemi që shtëpia jonë e përbashkët të mbushet sërish me jetë”*.

Jam i sigurt se secili prej jush do ta mirëpresë me dashamirësi dhe entuziazëm propozimin për ta kremtuar këtë Kohë të Krijimit: është e kotë të themi se është një temë që i përfshin shumë brezat e rinj për shkak të ndjeshmërisë së tyre dhe, për rrjedhojë, mund të jetë një mjet i dobishëm për fillimin e aktiviteteve të vitit të ri baritor 2023-2024, duke filluar pikërisht me fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë tanë që, në këtë periudhë historike kaq të veçantë, kanë nevojë të shoqërohen në motivimin e tyre për të bërë zgjedhje jete aktive.

I uroj secilit prej jush çdo të mirë në Zotin dhe ju bekoj me gjithë zemër.

† Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë



KAMPET VERORE NË KRYEDIOQEZËN TONË

Kampet e verore veprimtari kryesishtë më moshen e re tashme janë bërë takime të zakonshme në kryedioqezën tonë, duke u organizuar nëpër famulli, filiale apo qerdhe të ndryshme. Në vazhdim po i japim në formë kronike organizimet e zhvilluara gjatë muajt korrik e gusht.

Famullia e “Shën Kollit” - Shkrel 6 Korrik 15 Gusht 2023

Alpet janë tingulli që rrëfen historinë mijra-vjecare e cila ka pasuar ndër breza. Pikërisht në këtë vend ku vlerë të madhe njohin traditat, kultura dhe zakonet; kanë marrë frymë aktivitete të ndryshme këtë sezon veror. Kisha ka qenë gjithmonë udhëheqëse e denjë për secilen familje në Shkrel dhe kundrejt këtij besimi është ndërtuar një vijë komunikimi midis familjeve dhe kishës.

Vera e vitit 2023 ka sjellë nuanca të jashtëzakonshme të cilat lozin këndshem me njëra-tjetren. Këmbët e vogla puntore të fëmijëve që sillen me hare në oborrin e kishës i kanë dhënë një shkëlqim kampit veror këtë sezon. Është jashtëzakonisht bukur të shikosh sesi Fëmijët e Famullisë së Shkrelit kapen dora-dorës për të risjellë një frymë shpresëdhënëse për këtë vend.

Festivali i bërë me datë 23.07.2023 që aktiviteti që mbloodhi fëmijë, rini dhe familjarë për të shijuar një aktivitet me motive të ndërthurura nga ato moderne dhe kulturore. Xhubleta, pasqyrë e traditave malsore që peizazhi që i dha madhështinë koncertit të mbajtur në Shkrel. Natyra e gjelbërt që merrte frymë nën tingujt e çiftelisë ishte kopertina më e bukur që mund t'i vendosnim këtij koncerti të vogël artistik.

Dy grupe tjera iu bashkangjiten ishin grupet Scuot të ardhur nga Salento e Milano Itali të cilët sollën një tjetër frymë në ambientet tona. Këto grupe arriten të plotesojnë një pjesë të rendesishme të panoramës tone kete sezon. Në mesin e gjithë kesaj pamjeje dielli arriti të perendoje mes lojrave të pafundme të cilat u zhvilluan në natyrë. Bashkejtesa me ta ishte rrjedha e një bashke-ndarjeje të gjithanshme ku berthama lulezon mes një dashurie të pacmushme.

Aktivitetet verore u kurorëzuan në festën e Zojës së Ngjitur në qiell me ardhjen e bariut tonë mons Angelo Massafra ku dha sakramentin e krezmimit 25 të rinjve të famullis.

E për të gjitha këto qëndron një falenderim i pakufishëm për të madhin Zot i cili gjithmonë na motivon dhe na ndihmon kundrejt çdo hapi që hëllim në bashkësinë famullitare.

Dom Nikolin Toma
Famullitar i Shkrelit

Famullia “Naltimi i Kryqit” Stajkë

Me datën 31 korrik 2023 ka nisur kampi veror “Të humbur në drejtimin e Duhur”, ku morën pjesë rreth 80 fëmijë nga parashkolla deri në klasën e 9-të. Kampi zgjati dy javë, deri më 12 Gusht. Kjo kohë për të gjithë ishte një kohë angazhuese dhe që kërkonte shumë punë. Të punojë me fëmijët ishte një pasuri e çmueshme që ti e kupton pasi sheh gëzim në fytyrat e tyre. Për ta bërë me energjik kampin dhe argëtues menduam që përveç lojërave të ketë edhe bashkëpunime në grupe. Fëmijët në lojëra ishin të ndarë sipas moshave ndërsa në grupe kishte përzierje të moshave të ndryshme.

Ditën e fundit të kampit çdo grup ka përgatitur një punim mbi 12 ditët që kanë qenë në kamp, kemi patur sfida të ndryshme ndërmjet ngjyrave, një video me momentet më të bukura dhe argëtuese dhe kërcime. Fitues u shpall ngjyra Blu (Delfinët). Lojërat verore na bashkojnë të gjithëve, na mësojnë si të argetohemi, si të krijojmë dhe të bashkëpunojmë. Ne ishim të humbur në Jezusin, në fjalën e tij, në buzëqendhje dhe në perqafime. Të gjithë bashkë krijuam kujtime dhe shënime të reja në librin tonë të jetës.

Klaudia Ndoja

Kisha e “Shën Kollit” - Shkodër 10-22 korrik

Tashmë është bërë një traditë edhe për bashkësinë e Kishës së Shën Kollit që gjatë verës me organizuar lojërat me fëmijët, të cilët me shumë entuziazëm e presin këtë përvojë. Është viti i pestë që në ambientet e Kishës zhvillojmë kampin veror. Për dy javë rresht prej datë 10 deri me datën 22 korrik më shumë se 100 fëmijë kanë marrur pjesë në lojërat verore, fëmijët e disa lagjeve të qytetit Skënderbeg, Partizani etj..

Përveç momenteve argëtuese, kampi ka pasur si qëllim edhe edukimin e fëmijëve, në vlerat e forta njerëzore dhe fetare. Programi i kampin ka qenë mjaft i pasur, me tema formuese, me momentet argëtuese, dhe me një koktej të thjeshtë. Tema e Kampit për këtë vit ka qenë “SuperLibri”, i cili



trajton tema Biblike, çdo ditë kemi marrur nga një pjesë prej këtij filmi, duke filluar nga historia e krijimit të universit deri tek vdekja e Krishtit në Kryq, prej pjesëve të filmit kemi nxjerr mesazhe të përshtatshme për fëmijët.

Për këto dhe shumë arsye të tjera e ndje shumë përzemër që me falënderuar Zotin për këto përvoja të bukura që na jep duke na bërë pjesë të gëzimit të tij të vërtet.

Dom Kristjan Marku

parë në një kamp veror si animator.

Kampi veror në Barbullush u zhvillua nga data 17-27 korrik, ku një ditë e zakonshme e kampit niste me lutje në kishën e famullisë, për të vazhduar më pas me kërcime, lojrat me stenda (ku grupet kishin mundësi të fitonin sa më shumë pike) dreka, lojra me sfida (ku grupet konkurronin me njëri-tjetrin), shikimi i një pjese të filmit, dhe në fund pyetje e pergjigje rreth filmit.

Roza Qarri

Famullia “Zoja Rruzare”, Shkodër

Këtë verë, në famullinë tonë “Zoja Rruzare” u zhvillua kampi veror, tema e të cilit ishte “Ne jemi ngjyrat e botës”. Kampi u zhvillua nga data 5 deri me 15 korrik në ambjentet e famullisë, si edhe në filialen “Fusha e druve”. Gjatë këtyre 10 ditëve trajtuam temën e ngjyrave të ylberit, ku diskutuam mbi rëndësinë dhe domethënien e tyre, sidomos në jetën tonë të krishterë. Sikurse ngjyrat i japin kuptim e bukuri botës, ashtu edhe ne jemi të thirrur ta ngjyrosim e ta zbukurojmë botën me dëshminë e jetës sonë.

Përveç formimit, një pjesë tjetër e veçantë e kampit tonë ishin edhe lojërat e ndryshme në ambjentet e famullisë të përgatitura nga motrat dhe animatorët, të cilat u dhanë gëzim fëmijëve gjatë këtyre ditëve. Të qëndruarit së bashku duke bashkëpunuar na bën që të kuptojmë më mirë vlerën e njëri-tjetrit dhe praninë e Zotit në jetën tonë.

Ylberi është shenjë e shpresës dhe e paqes për të ardhmen, kështu kur një shi i mirë lag tokën dhe kur ylberi të shfaqet në qiell të mos harrojmë të duam dhe të vlerësojmë njëri-tjetrin, ashtu si Jezusi na ka lënë porosi ta duam të afërmin si vetveten.

Donalda Kroni

Animatore

Famullia Dajç - Bregu i Bunës

Kampi veror i mbajtur në fillim të muajit gusht në famullinë Dajç B.Bunës, i nisur me sekuenca nga filmi vizatimor "Në kërkim të Dorit", u dëshmuar të ishte një përzierje e jashtëzakonshme edukimi, frymëzimi dhe argëtimi. Fëmijët nisën një udhëtim të pasur zbulimi, duke u zhytur me padurim në një mori njohurish të reja. Të udhëhequr nga narrativa e filmit, sekuencat interaktive gërmuan në sferën magjepsëse të jetës detare, duke nxitur një atmosferë të mëvonshme mësimi entuziast.

Porse kampi nuk qe i kufizuar vetëm këtui; ai siguroi një platformë të shkëlqyer për të ushqyer besimin e fëmijëve, duke u mundësuar atyre të reflektojnë në lidhjen e tyre me Zotin, si dhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Nëpërmjet diskutimeve nxitëse dhe aktiviteteve mjaft tërheqëse, arritën të nxirrnin konkluzione në sjellje dhe edukatë, duke lënë një ndikim të qëndrueshëm. Fëmijët pjesëmarrës, vendas dhe emigrantë, i bënë jehonë një kori mirënjohjeje dhe gëzimi për përfshirjen e tyre në këtë ngjarje të orkestruar me përpikëri. Çdo ditë ishte një simfoni harmonike edukimi dhe argëtimi, duke i lënë ata të ndiheshin me fat që ishin pjesë e një eksperiencë të tillë.

Aurelio Vneshta

Famullia “Zoja e Ngjitur në Qiell” - Barbullush

Këtë vit, në famullinë “Zoja e Ngjitur në Qiell” në fshatin Barbullush u organizua kampi veror me temë “Luka” nën drejtimin e famullitarit tonë dom Marjan Gjinesha.

Fëmijët ishin të ndarë në dy grupe: grupi “Toka” dhe grupi “Uji”, që përfaqësonin dy jetët e personazhit kryesor, Lukës. Për të drejtuar lojrat ishin përgjegjës një grup prej 15 të rinjsh, nga mosha 15-21 vjeç, të cilët (disa) merrnin pjesë për herë të

Famullia, “Dashuria e mëshirshme”, BORIÇ

Famullia e Boriçit në këtë verë 2023 pati hirin të përjetonte dy kampe verore.

I pari u zhvillua në dy javët e fundit të qershorit ku fëmijët dhe adoleshentët morën pjesë në takime, lojëra dhe lutje dhe ditë pas dite patën mundësinë të njihnin një cilësi të Zotit: “Zoti është... gëzim, paqe, forcë, i shenjt!” Në takime morën pjesë rreth 100 fëmijë nga të gjitha fshatrat e famullisë sonë. I gjithë itinerari u drejtua nga meshtarët Dehonianë, motrat baziliane dhe animatorët shqiptarë. Në pjesën e vet



fetare, tema e kampit synonte t'i afronte fëmijët të Zotit, të tregonte madhështinë dhe afërsinë e tij. Kulmi i kampit ishte dita e fundit e qershorit, kur skuadrat e ndryshme vinin me radhë në kishë për të adhuruar Jezusin në të shenjtërueshmin Sakrament dhe për të marrë bekimin.

Kampi i dytë veror u zhvillua nga 1 deri më 5 gusht. Një grup vullnetar skautësh nga Forli (Emilia Romagna) ishte i pranishëm, i shoqëruar nga disa anëtarë të komunitetit misionar të Villaregia.

Skautët nga Forli kanë patur mundësinë të përjetonin, mikpritjen dhe bashkëpunimin me disa të rinj shqiptarë duke u vënë në shërbim të fëmijëve të famullisë dhe invalidëve të shtëpisë së Motrave të Nënë Terezës. Vështirësitë nuk kanë munguar për shkak të gjuhës dhe mungesës së vëmendjes ndaj rregullave nga ana e fëmijëve dhe të rinjve. Në fund të kampit, lotët dhe përqafimet e pjesëmarrësve kanë shpërblyer mundimet e tyre dhe vulosur një miqësi që mund të vazhdojë me kalimin e kohës.

Ate Gianni Dimiccoli, Dehonian

Qendra Jezusi Bari i Mirë Fermentim - Shkodër 2023

Periudha verore në Qendrën Baritore “Jesusi Bari i mirë” në Fermentim, ka qënë një kohë shumë intensive mes aktivitetesh dhe kampesh verore të zhvilluara, si në qendër dhe jashtë saj. Kjo mundësi na është ofruar nga dashamirësia e shumë personave që bujarisht na mbështesin që fëmijëve të Fermentimit t’iu ofrohet mundësia e një rritjeje dhe përforsimi si nga ana njerëzore, shpirtërore dhe të shëndetit fizik.

Në muajt qershor- korrik, kemi zhvilluar dy kampe verore, i pari (në qershor) për fëmijët e Kungimit të parë dhe në korrik për grupin e Krezmimit. Për të zhvilluar këta dy kampe kemi qënë të mirëpritur nga Fra. Andreas Walerman Eterit Kapucin, dhe nga motër Grazia Ruf, misionarë që të dy nga Germania. Ata për disa vite me radhë, me shumë bujari, na kanë ofruar shtëpinë dhe ambjentet e përshtatshme për të zhvilluar kampet, në fshatin Kryezi të Pukës.

Në motrat baritore, me ndihmën e animatorëve i kemi shoqëruar fëmijët për një njohje me të thelle të vetvetes, të rritjes në marrëdhënie të shëndetshme mes njeri tjetrit dhe të një rritjeje shpirtërore në marrëdhënie me Hyjin, të udhëhequr nga Fjala e Zotit. Tekstet biblike që na kanë shoqëruar kanë qënë: Historia e Moisiut dhe Ungjilli i Mateut. Momentet e lutjes, të reflektimit dhe të aktiveve të ndryshme së bashku, çdo ditë e më shumë ka

perforcuar në ta një rritje vëllazërore me vlera ungjillore. Një element shumë i rëndësishëm që ka ndikuar pozitivisht tek fëmijët ka qënë klima e vendit, me ajrin e pastër, gjelbërimin, ujin e freskët dhe natyrën shumë të bukur që Zoti ka krijuar.

Kampin e tretë që kemi zhvilluar në fund të korrikut e kemi organizuar me fëmijët nga mosha 6-12 vjeç, në Velipoje. Kjo mundësi për ti dërguar fëmijët në plazh na është ofruar për tre vite radhazi nga Urdhëri i Maltës “Malteser”, që i falenderojmë për bujarinë e ofruar fëmijëve tanë, për një shëndet më të mirë, dhe bashkëndarjen e kësaj eksperience me fëmijët e tjerë, të zonave të ndryshme.

Motrat Baritore

Fermentim-Shkodër 14 gusht 2023

Kampi veror në Famullinë “Zoja e Rruzares ” Bardhaj, nën mbështetjen ekonomike të organizatës World Vision dhe Caritas Dioqezane, me një kohëzgjatje 2-javore, filloi me datë 31 korrik dhe përfundoi me 11 gusht, me një shfaqje përmbyllëse të përgatitur nga animatorët, fëmijët dhe grupi i skautistëve për prindërit.

Formimi i përgjithshëm i grupit të 35 animatorëve zgjati nga 1-30 korrik, me takime të përditshme dhe me praninë e të gjithëve, ndërsa 10 prej këtyre animatorëve tanë patën mundësinë të certifikoheshin për pjesëmarrje në formimin e animatorëve dioqezan në Fshatin e Paqes.

Ne si Famulli, ishim me fat, që gjatë kampit veror të kishim të pranishëm mes nesh 3 seminaristë nga Molfetta (javën e parë), dhe një tjetër grup prej 27 skautistash nga Bergamo në javën e dytë, të cilët dhanë kontributin e tyre të vyer në mbarëvajtjen e kampit.

“T’i japim paqes edhe një shans”, kjo ishte tema e kampit veror të këtij viti, temë e cila u mbështet në historinë e “Princit të Vogël”. Cdo ditë, një grup animatorësh, “nën petkat” e të gjitha personazheve të librit, interpretonin para fëmijëve fragmente të ndryshme të shkëputura nga libri (në formë dialogu apo monologu). Përmes këtij interpretimi, bashkëndahej fillimisht tema e ditës me praninë e të gjithë fëmijëve, dhe ku pastaj diskutohej më gjerësisht nëpër grupe. Në kamp morën pjesë 100 fëmijë të cilët ishin të ndarë në 4 grupe. Grupet përkatëse të fëmijëve mbanin emrat e 4 personazheve kryesore të librit “Princi i Vogël”, të cilat ishin: Princi i Vogël, Aviatori, Trëndafil dhe Dhelpra.

Dhe si kujtim nga Kampi Veror, në fund të shfaqjes, secilit prej fëmijëve iu dorëzua libri i “Princit të Vogël”.



Don Lush GJERGJI

PROFETI I MADH I EKUMENIZMIT

ATENAGORA I (1886 – 1972) – në përvjetorin e vdekjes – 7 korrik 1965

Ai që pati guxim, fe, dashuri që t'i rrënonte prangat e mallkimit të ndërsjellët mes Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse!

Shekulli njëzet është plotë sfida të llojeve të ndryshme. Në prag të festës së dymijë vjetorit të krishterimit Gjon Pali II thoshte: „*Dimensioni gjithëpërfshirës ekumenik i Jubileut të Shenjtë do të jetë i cekur në mënyrë të qartë me takimin e gjithë krishtere.*“

Për Kishën katolike janë dy sfida kryesore dhe shumë të rëndësishme, ndoshta edhe vendimtare për gjithë të krishterët, dialogu ekumenik me Kishat simotra të krishtera të ndara dhe dialogu ndërfaqetarak me gjithë botën.

Profeti i madh i ekumenizmit ishte patriku i Konstatinopojës Atenagora I, njeri i Zotit dhe Kishës, ai që pati guxim, fe, dashuri që t'i rrënonte prangat e mallkimit të ndërsjellët mes Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse. Emri i tij i pagëzimit është Aristokle, kurse emri familjar Spyrou; ai u lind në Tsaraplanë, tani Vassilikon, me 25 mars 1886, në Greqinë e sotme, në zonën kufitare me Shqipërinë. Ishte kjo periudhë e mbretërisë Otomane me përzierje të popujve, gjuhëve, kulturës, besimeve dhe traditave të ndryshme. Patriku Atenagora e kujton fëmijërinë e tij kështu: „*Kur vinte nata të gjithë mbledheshim rreth vatrës, të ulur në tokë, „këmbëkryq“ „alla turka“.*

Babai i Aristokleut, Mateu, ishte mjeku i parë në fshat. Ja se si e përkujtonte atë Patriku Atenagora: „*Babai im ishte mjeku i fshatit; mendoj se ishte mjek i mirë, iu jepte njerëzve shpresë. Gjithnjë udhëtonte me kalë, sepse e ftonin prej fshatit në fshat.*“

Nëna e patrikut ishte bijë e një zejtarit – këpucëtarit të njohur, i cili kishte disa punëtorë. Quhej Elena. Ishte e shkolluar, sepse kishte vijuar një shkollë private greke dhe aty kishte arritur edhe diplomën. „*Ishte nga Konica*“ rrëfen Atenagora, „*nga një mes i shqiptarëve që ishte më i rëndësishëm dhe me ndikim se sa Tsaraplana dhe më shumë përparimtarë...*“



Rrënjët e ekumenizmit në familje

Aristokle Spyro qysh në rrethin familjar jetoi bashkimin e dashurisë në dallime dhe pluralizmin. Atenagora rrëfente kështu: „*Ne Tsaraplanë të krishterët dhe myslimanët jetonin në harmoni të madhe. I vetmi polic turk, ende e kujtoj emrin e tij, Ali Bey, nuk kishte fare punë. Asnjë përplasje, konflikti, procese gjyqësore. Fëmijët e krishterë dhe ata myslimanë loznin gjithnjë së bashku. Gjatë pagëzimeve të fëmijëve ishin të ftuar dhe të pranishëm edhe miqtë myslimanë, edhe ata na ftonin për rreth prerjen e fëmijëve të tyre. Ishte kjo jetesë biblike, ku të gjithë ne ndiheshim fëmijët e Abrahamit.*“

Ndikim të madh dhe vendimtar në jetën dhe edukimin e Aristokleut të ri padyshim patën prindërit e tij: „*Babai im ishte fetar, por në mënyrë*



diskrete, ishte më tepër i mbyllur. S'fliste për fe. Mirëpo, para bukës bënte kryq dhe shkonte për çdo të diell në kishë. Ndaj nesh ishte njeri i rreptë, por jo edhe zemërgur. Unë isha biri i parë, pastaj vëllai im i cili vdiq në vitin 1948, kurse e treta ishte motra e jonë...S'kam asnjë fotografi të nënës sime. Në atë kohë, nëpër fshatra s'kishte fotografi...E dimë nga dëshmitë e kohës që Helena ishte e bukur. E quanin 'hylli i mbrëmjes'. Ishte e gjatë, e hollë, kishte pamje mbretëreshe... Edhe sot në Vassilikon flitet si ajo ishte bamirëse... Nëna e jonë ndezi në ne fenë. Feja e saj ishte e flakët, tërheqëse. Në mbrëmje për të na vënë në gjumë, na këndonte me zë të ulët himne fetare. Ishte shumë e përshtirshme.

Kjo harmoni dhe lumturia e familjes u rrënuar shumë me vdekjen e së ëmës sonë Helenë. Isha 13 vjeçar. Nëna ime dhe unë gati njëkohësisht jemi sëmurë. Unë e humba edhe vetëdijen; për shumë ditë mbeta i tronditur. Kur erdha në veti, fitova vetëdijen, e kërkoja kot nënën time. Babai im më shpjegoi se kishte shkuar te dajhtë në Konicë...Nuk ishte e mundur t'i mbajmë dy të sëmurë të rëndë në shtëpi, më tha. Pritsha që nëna ime të kthehej... Një ditë, ndërsa isha në oborr, hyri një njeri dhe më pyeti: „A banon këtu Mateu Spyrou të cilit para

disa kohe i ka vdekur gruaja?“ Kështu e kuptova se nëna ime kishte vdekur para tre muajve. Ishte 37 vjeçare. Kurrë nuk jam ngushëlluar. Më ka munguar dhe do të më mungojë gjithmonë.“

Patriku Atenagora është me prejardhje, gjuhë, kulturë, edukatë shqiptar. Dëshminë e drejtpërdrejt mbi këtë e shkroi atë Giuseppe Ferrari, italo-shqiptar: “Me prejardhje jam nga një vend i vogël në veri të Epirit, në afërsi të kufirit shqiptar...Duke i hapur duart nga unë, me një buzëqeshje të gjatë, klithi në gjuhën shqipe 'Mirë se erdhe'! Edhe unë jam shqiptar si ti. Shqipëria ka qenë vazhdimisht në mes të Lindjes dhe Perëndimit. Në vende tjera kanë luftuar në mes veti, por në Shqipëri ortodoksët dhe katolikët kanë bashkëpunuar mirë. Ju, pra, mund t'i kuptoni më mirë problemet ekumenike. Ndoshta Provania hyjnore iu ka transferuar në Itali për ndonjë rol të dobishëm për planet e tija.”

Patriku Atenagora I shpesh ceku prejardhjen e tij shqiptare që edhe me këtë të tregonte se si erdhi deri tek përvoja ekumenike qysh në atmosferën familjare, nga një popull historikisht i vogël, i cili është i ndarë në dy fe, krishterimi, që nga kohërat apostolike, dhe islam, pas sundimit pesëqind vjeçar turk (1468 – 1912). Krishterimi në popullin shqiptar ndahet në dy Kisha: Katolike dhe Ortodokse.

Si njohës i mirë i historisë shqiptare patriku Atenagora ndër të tjera ka thënë: “Populli shqiptar është një ndër popujt që ka vuajtur më së shumti në Evropë, ka vuajtur gjatë shumë shekujve, pasi mbrojtje në mënyrë të mrekullueshme krishterimin...Unë jam shqiptar...Jam në shërbim të Kishës ortodokse, edhe më tepër, të Jezu Krishtit...Të jeni të bindur se sistemi ateistokomunist i Shqipërisë do të kalojë, mirëpo krishterimi do të mbetet përgjithmonë.”

Thirrja e Atenagores

I riu Aristokle Spyrou mendon seriozisht për jetën, lutet, kërkon, jeton me fe, mirësi, me përshtirshërinë e nënës së tij të ndjerë Helenës. Në veçanti mendon mbi kuptimin e jetës, vuajtjes, vdekjes duke u nisur nga provoja e tij. Përpos këtyre pyetjeve, i imponohet edhe pyetja e ardhmërisë së tij, përcaktimit dhe thirrjes jetësore. Lexonte shumë, lutej, kërkoi rrugën e vërtetë.

Në vitin 1908 papritmas vdiq edhe i babai Mateu duke zbritur prej kalit. Aristokli ishte 22 vjeçar, pra, në moshën më të mirë...Pas shumë meditimesh dhe



uratash kishte vendosur: do t'i kushtohem krejtësisht Zotit dhe Kishës së tij, si mug – xhakon. Studimet teologjike i vijoi në qendrën e rëndësishme kulturore dhe fetare në Halki. Në vitin 1910 shugurohet xhakon, pas përfundimit të studimeve dhe përgatitjes së thellë shpirtërore. E zgjodhi edhe emrin e ri rregulltar - Atenagora.

Pas shugurimit për xhakon ishte në shërbim të Kishës dhe popullit së bashku me ipeshkvin Stefani në Manastir në Maqedoni që nga viti 1910. deri 1919. Atëherë Manastiri ishte qendër e rëndësishme politike, ekonomike, fetare dhe kulturore. Përbërja e banorëve ishte kjo: 30. 000 turq (në masë të madhe shqiptarë të islamizuar), 15.000 grekë, 5.000 bullgarë, 3. 000 serbë. Sipas kësaj shihet se Manastiri ishte një mozaik i vërtetë popujsh, religjionesh, gjuhësh e kulturash. Atenagora ishte apostull i vërtetë i gjithë atyre që vuanin, pa farë dallimi. U flijua për të mirën e përgjithshme dhe shpeshherë që edhe në rrezik jete duke mbrojtur jetën dhe të drejtat e të tjerëve.

Në themele të kësaj përvoje dhe jete në mesin e popujve dhe feve të ndryshme më vonë do të thotë: *“Në Manastir i njoha mirë sllavët. Kam vështruar edhe gjermanët dhe austriakët. Me francezë kam jetuar dy vite. Të gjithë popujt janë të mirë. Çdo njeri meriton nderimin dhe për bindjen. Kam parë vuajtjen e njerëzve. Të gjithë kanë nevojë për dashuri. Nëse janë të këqij, janë të tillë sepse nuk kanë takuar dashurinë e vërtetë, atë dashuri e cila nuk shpenzon shumë fjalë por rrezaton me dritën e jetës... Dashuria e Krishtit është më e fortë se Ferri. Në dashurinë e tij hasim guximin që të duam njerëzit dhe me këtë zbulojmë se të tjerët janë domësdoshmërisht të nevojshëm për të pasur mundësi të qëndrojmë dhe të jemi të krishterë...”*

Prej vitit 1912 e deri në vitin 1919 Manastiri ishte bërë epiqendër e luftimeve të ashpra. Atenagora, që ishte së bashku me metropolitin Krizostemi, u mundua me mish e shpirt për të mirë të të gjithëve.

Atë i të gjithëve

Në vitin 1909 u deshtë ta braktiste Manastirin dhe të kalonte në Malin Athos (në Greqi), ku atëherë kishte 7. 000 murgj. Mirëpo, pas gjashtë muaj paqeje, qetësie, urate me një rreth rregulltarësh nga shumë vende të botës ortodokse, Atenagora duhet të largohet prej Athosi për një mision të ri: emërohet sekretar i Sinodit të Shenjtë të Athinës, që ishte pozitë me rëndësi dhe ndikim të madh për jetën dhe veprimtarinë e Kishës Ortodokse. Edhe në këtë detyrë të lartë, me shumë përgjegjësi dhe vështirësi, ai punoi për çështjen

ekumenike. Edhe në këtë detyrë u tregua i përgatitur dhe i aftë për punë, i hapur dhe komunikativ me të gjithë, i përkushtuar jetës së përsëpirtshme fetare me të gjitha forcat e tij. Në moshë 37 vjeçare emërohet ipeshkëv dhe metropolit i Korfus-it dhe Paksosit (1923 -1930).

Në Korfus ishte gjendja tejet kaotike. Mijëra mërgimtarë hebrenj kërkonin strehim nëpër shkolla dhe nëpër kisha. Me pasuri të kishës dhe me ndihmë të bamirësisë së besimtarëve nisi ndërtimin e shpejt të banesave. Në rezidencën e vet hapi një qendër shëndetësore falas dhe një shërbim për strehimin e tyre... Gjeti vend dhe zgjeroi shkollat për fëmijët e të ikurve. Me kënaqësi dhe shpesh i vizitoi të varfëritë dhe të sëmurët, njerëzit e braktisur. Një herë me ironi tha: *„Kush vdes nga uria s'ka nevojë për pendesë“* Nëpërmjet dashurisë dhe kujdesit shumë shpejt u bë babai i të gjithëve, i respektuar dhe dashur nga populli pa farë përjashtimi. Në shërbimin e përditshëm të Hyjit, Kishës, popullit, të gjithëve iu dha forcë, frymëzim, por edhe kënaqësinë e jetës dhe përkushtimit të krishterë.

Mirëpo, Zoti e „sprovon“ edhe një herë, ia rrënon sigurinë në vazhdimësi, e shqetëson dhe sfidon. E pret edhe një befasi, ndërrimi, ndryshimi. Amerika ka nevojë për një bari dhe atë shpirtëror, sepse atje ka shumë ortodoksë nga gjitha pjesët e botës, të gjithë në kërkim të fatit dhe kushteve më të mira jetësore.

Argjipeshkëv në Amerikë

Sinodi emëroi Atenagoren argjipeshkëv në SHBA (1930) për besimtarët greko-ortodoksë. Atë që deri atëherë e kishte përjetuar si „miniaturë“ në Vassilikon, Konicë, Janinë, Manastir, Korfus, tani do jetojë në kontinentin e ri: mozaik i dallimeve të ndryshme të të gjitha llojeve.

Gjatë 17 viteve të punës dhe shërbimit pastoral pati suksese të jashtëzakonshme në Amerikë në çdo lëmë. Ja vetëm disa të dhëna: organizoi një tërësi organike me afro 400 famulli /ortodokse/, me afro 10 ipeshkëvij ndihmës, afro 500 meshtarë, dy shkolla teologjike, më se 300 shkolla për fëmijë dhe për nxënës grekë.

Amerika është multietnike, multifetare dhe pikërisht për këtë pyetja e dialogut ekumenik edhe për Atenagoren nuk ishte pyetje teoriko – spekulative, filozofiko – teologjike, por para së gjithash praktike, çështje e përditshme, e rëndësishme dhe jetësore që e përcolli gjatë tërë jetës. Ndarjet e brendshme të krishterëve për te ishin një plagë e madhe në Trupin mistik të Krishtit – Kishave, kështu që punoi duke u munduar rreth dialogut, nderimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellët



në përpjekje dhe guxim të kërkimit të bashkimit në dallime.

Punoi po ashtu mjaft dhe suksesshëm edhe me pushtetet politike, në veçanti me kryetarin Franklin Roosweltn dhe Harry Trumanin.

Zoti edhe një herë kishte planin e tij me Atenagoren. Por, ja prapë befasia: më 01. XI. 1948 Atenagora u zgjodh Patrik i gjithmbarshëm i Konstatinopojës. Rrethanat ishin vërtet të jashtëzakonshme. Patriku i mëparshëm, Maksimi V, ishte ende i ri, në moshën 52 vjeçare, i zgjedhur vetëm para dy viteve. Mirëpo, gjendja e tij shëndetësore e detyroi për dorëheqje. Pse që zgjedh pikërisht Atenagora? Me siguri se ka shumë arsye, sidomos: për përvojën e tij të madhe baritore, për veprimtarinë e tij të larmishme, për autoritetin të gëzonte veçanërisht në SHBA, si dhe për çështje politike të acaruara në mes të Turqisë dhe Greqisë.

Atenagora I arriti në Konstatinopojë (Stamboll) më 26 janar 1949 me aeroplanin personal të kryetarit Truman dhe që intonizuar një ditë më vonë. Në fjalimin e tij të parë foli qartë „për t'iu

dhënë të gjitha Kishave të krishtera bashkimin dhe paqen, për t'u bërë ato burim i paqes për popujt. “

Atenagora para së gjithash forcoi bashkëpunimin mes Kishave të ndryshme nacionale ortodokse: organizoi pesë Konferenca gjithëpërfshirëse ortodokse gjatë vitit 1969: ka shkatërruar kundërshtimet që i kundërvinin Konstatinopojën dhe Moskën. Ka bashkuar Ortodoksinë duke bërë primatin e Konstatinopojës jo pushtet juridik për të sunduar apo qortuar, por në stilin e Ungjillit, primat dashurie dhe shërbimi ndaj Kishave simotra.

Në vitin 1950 Atenagora e shpalli enciklikën e parë të gjitha Kishave ortodokse në botë, ku i fton në bashkim të fesë „për ta përgatitur bashkimin e të gjitha Kishave të krishtera në botë“.

Në vitin 1957 filloi takimet e para me Kishën katolike nëpërmes Delegatit Apostolik në Konstatinopojë, Mons. Giacomo Testa-s, që vite me radhë ishte sekretar i posaçëm i Imzot Angelo Roncalli-t, papës së mëvonshëm Gjoni XXIII.

Gjithë jeta dhe veprat e Atenagora I, ishin të



udhëhequr nga dashuria ndaj Zotit, Kishës, ndaj njeriut dhe botës bashkohore.

Miqësia me papët Gjoni XXIII dhe Pali VI

Provania përgatiti edhe një personalitet të madh nga Kisha Katolike, papën Gjoni XXIII, që të kenë mundësi së bashku të punojnë për bashkimin e të gjithë të krishterëve.

Atenagora I pas shpalljes së Koncilit Dytë të Vatikanit (më 25 janar 1959) tha: *“Bashkimi i të krishterëve është bërë një nevojë aq e qartë, sa që, nëse nuk do të arrihet sa më parë një 'bashkim së paku i kushtëzuar' në mes të tri bashkësive kryesore të krishtera: Kishës katolike romake, protestante dhe ortodokse, Kishës i kanoset rreziku i humbjes së misionit të saj, sepse, nëse s'do të vihet deri te bashkimi, ajo do të humbë shumë besueshmërinë.”*

Kështu filloi bashkëpunimi vëllazëror i këtyre dy krerëve kishtarë në dobi të afrimit ndërkishtar katoliko-ortodoks, të ekumenizmit të frytshëm me nderim dhe dashuri të ndërsjellë.

Gjoni XXIII lëvizi botën dhe së shpejti vdiq, në pikëllim të të gjithëve. Atenagora I i tronditur tha: *“Sa me gëzim kemi dashur ta vizitojmë Romën e ta përqafojmë atë, të qajmë së bashku me të për shkak të përçarjes dhe ndarjes mes nesh gjatë gjithë këtyre shekujve, të tregojmë pendimin tonë për shkak të kaluarës dhe gëzimin për shkak të ardhmes.”*

Bashkëpunimi vazhdoi dhe u konkretizua me papën Pali VI. Me rëndësi historike janë tre takimet mes Palit VI dhe Atenagora I: në Jerusalem (5 shkurt 1964), në Konstantinopojë (15 qershor

1967) dhe në Romë (27-28 tetor 1967).

Në Jerusalem mes të tjerash Atenagora I tha: *“Duke shqyrtuar këtë takim si një ngjarje të jashtëzakonshme në historinë dhe në jetën e Kishës së Hyjit..., dëshirojmë qëllimet e mira...të bëhen parahyrje e bashkimit të ndërsjellët të vullneteve dhe nënshtrimit i plotë të Vullnetit të Shpirtit Shenjt të Zotit...”*

Me shekuj bota e krishterë jetoi në natën e ndarjes. Sytë e tyre janë të lodhur duke shikuar në errësirë. Dhashtë Zoti që ky takim të jetë agim i ditës së lume dhe të bekuar, kur breznitë e ardhshme, duke u ushqyer nga i njëjti kelk i Korpit të Shenjtë dhe i Gjakut të paçmueshëm të Zotërisë, do të lavdërojnë dhe lumturojnë në dashuri, në paqe dhe në bashkim të vetmin Zotëri dhe Shëlbuesin e botës...Ja, duke kërkuar këtë takim të përbashkët ne e kmei gjetur së bashku Zotërinë. Të vazhdojmë, pra, rrugën e shenjtë që hapet para nesh...”

Një nga frytet më të mëdha të këtij takimi dhe përqafimit historik gjithsesi është heqja e mallkimit të ndërsjellët (7 dhjetor 1965) Atenagora duke folur për mallkimin – përjashtimin e vitit 1054, ai ndër të tjera tha: *“Ky gabim në mes Kishës së Romës dhe të Konstantinopojës, duke imituar dashurinë dhe mirësinë e Zotit ndaj njeriut, na detyron për këtë arsye në rikthimin e paqes...”*

Me rëndësi historike ishte edhe vizita e papës Pali VI Konstantinopojës, i cili në Katedralen e Fanarit, ku ndër të tjera pati thënë: *„Ne përkujtojmë këtu katër koncilët e mëdha ekumenike në Nice, në Konstantinopojë, në Efez dhe në Kalcedoni, që etërit kishtarë s'kanë pasur frikë t'i krahasojnë me katër Ungjijtë...”*

Në fjalën e rastit Patriku Atenagora I ndër të tjera iu përgjigj Papës kështu: *“Shenjtëri dhe i dashuri vëlla në Krishtin. Duke dëshiruar mirëardhje, fortë i shenjtë pasardhës i Pjetrit, që e bartni emrin dhe keni sjelljen e Palit, kasnec i dashurisë, bashkimit dhe paqes...Ne përshëndesim ardhjen Tuaj në Lindjen tonë si një agim të ri të dritës së ndriçuar nga Zotëria, në historinë e dy Kishave tona, të Romës dhe të Konsantinopojës, të botës ortodokse dhe katolike, të gjithë besimtarëve dhe të botës mbarë. Mirë se vjen, Vëlla, në emër të Zotit!”*

Në takimin e tretë mes Atenarorës I dhe Palit VI në Romë iu dha ekumenizmit një nxitje dhe inkurajim. Me atë rast Patriku Atenagora mbajti fjalën e rastit para kardinajve dhe anëtarëve të Sinodit ipeshkvor, ku ndër të tjera tha: *„Ne mendojmë kah çasti i madh dhe i shenjtë, kur ipeshkvinjtë e Perëndimit dhe të Lindjes do të bashkëmeshojnë në të njëjtin altar, duke ngritur*



kelkun e Zotërisë nga Eukaristia e përbashkët. “

Trashëgimia e tij shpirtërore

I madhi, mund të themi edhe i shenjtë, Patriarku ekumenik Atenagora I vdiq më 7 korrik 1972, pas tetë ditë sëmundjeje. Vdekja e tij ishte humbje e madhe, jo vetëm për Kishën ortodokse, por edhe për mbarë krishterimin, do të thoja edhe për tërë njerëzimin.

Me 9 korrik Papa Pali VI duke iu folur besimtarëve në Sheshin e Shën Pjetrit, tha: “Ju e dini pse Ne e përkujtojmë këtë njeri të madh të Kishës së nderuar; por ende jo tërësisht të bashkuar me Kishën Katolike; e porosisim në kujtime dhe uratë tuaja: sepse ai ishte mjeshtri i gjithëanshëm dhe apostull i bashkimit të Kishës greko-ortodokse me atë të Romës, si dhe Kishat dhe bashkësitë tjera të krishtera, ende të pabashkuar në të vetmin bashkim të Korpit mistik të Krishtit. Ai e ka pasur vetëm një shpresë të lartë: atë që të mund të pinte së bashku me Ne „nga i njejtë kelk“. Kjo dëshirë e pazbatuar duhet të jetë trashëgimia e tij dhe kujdesi ynë”.

Atenagora I ishte pikësëpari njeri i Zotit, njeri i Kishës, ekumenizmit, lëvizës i madh i bashkimit të krishterëve. Shpeshherë thoshte; „Zoti është afër

nesh dhe me Të edhe njerëz janë të afërt. Nëpërmes Krishtit ne kemi zbuluar se Zoti është Dashuri. “

Duke menduar mbi ndarjen e Kishave dhe të krishterëve me zemërim në zemër komentoi: „Çka kemi bërë ne? Çka kemi bërë? Krishti ka hequr dorë prej nesh. Ne e kemi dëbuar atë. Me armiqësitë tona, me krenarinë tonë, me paturpësinë tonë farizeje, ne kemi fyer shpirtin e Ungjillit... Krishti është larguar... Ku do të ketë shkuar?... Shkon si shtegtar, si i panjohur në mesin e të varfërve, të braktisurëve e të lënëve të këtij vendi. Ku do mund të ishte? Ndoshta në Indi, apo Afrikë? Apo në lagjet e mjerueshme të qyteteve të mëdha? Mirëpo, ne nuk mund të jetojmë pa Të, nuk mundim. Duhet ta gjejmë atë... Unë nuk merrem me politikë. Ajo s'më intereson... Mua më intereson Krishti dhe Kisha e tij, bashkimi i Kishës në paqe e dashuri. Dialogu do të sqaronte shumë pyetje... Ne të krishterët duhet palodhshëm të kërkojmë bashkimin e Kishave simotra dhe vëllazërimin e popujve. “

Atenagora I ishte dhe mbeti jetë, porosi, dëshmi të cilën ia vlen ta zbulojmë. Dhe trashëgimi të cilën duhet ndjekur, jetuar sot e në të ardhmen.





SHËN LUIGJ GONZAGA DHE NDRE MJEDA

Kisha katolike më 21 qershor përkujton njërin nga shenjtoret më të njohur, Shën Luigj Gonzagën, rregulltar jezuit, një jetë e shkurtër, ajo e Shën Luigj Gonzagës, por me gjurmë të thella, la pas një thesar vlerash.

Shën Luigji vdiq duke ndihmuar të sëmurët nga kolera, që bënte kërdinë në Romën e kohës së tij: pikërisht duke mbartur një nga këta të sëmurë, që po vdiste në rrugë të madhe, u sëmur edhe ai vetë e edhe vdiq nga e njëjta sëmundje, në moshën 23 vjeçare. Kështu mund të themi se jeta e tij u vu edhe në shërbim të shoqërisë, të ndihmës shoqërore, të varfërve, të braktisurve të Romës.

Për besimtarët katolikë shqiptarë, njohja nga afër e Shenjtut të Rinisë, Shën Luigjit Gonzaga është bërë nga vepra origjinale e priftit dhe shkrimtarit të madh shqiptar, dom Ndré Mjedjës: “Shën Luigj Gonzaga, Projsi i pergjithtë i moshës së rë”.

Në XXI kapituj të veprës tregohet jeta dhe vepra e Shenjtut që u shpall nga Papa Piu XI “Pajtor i rinisë”, ndërsa në kapitullin e XXII e të fundit botohet Letra Apostolike që Piu XI i drejtoi Eprorit Gjeneral të Shoqërisë së Jezuitëve me rastin e kremtimeve të dy qindvjetorit të shenjtërimit të Shën Luigjit, përmes së cilës, siç thotë ai vetë, ka për qëllim t’i flasë mbarë moshës së rë.

Në kreun e parë - siç e quan dom Ndré Mjedja, lexojmë: “Luigj Gonzaga! Ëmen qi ká mbushë tokën me fatosa e qiellen me ëjë; që ka begatë bashtinën e Jezu Krishtit me punëtorët mǎ të vjefshem; qi ká bâ me lulëzue nder kolegja e nder kuvende zamakët mǎ të kândshem të nji pastrís ëjëllore; qi ká xé mjeshtat mǎ të mëdhaj të harteve të bukra, me shkri dijen e mjeshtërín e vet me përhapë fëtyren e tij në të kater anët e botës; me ndertue ltérna e kisha gjithkú permëndet fëja e Krishtit, prei qëndres së Kështënimit në Romë, e deri në mǎ të largtin katund ndertue rishtas prei gjindsh, qi vllaznit e tyne të gjytnuem kerkuene nder pyje të páshteg, nder shkretína të mndërshme të Afrikës e t’Amerikës, e joshne me u mbledhë së bashkut , për të paren herë me kalue nji jetë njerzore; emën që lëshon nji erë të kandshme në zemrë të nanave, qi hitasin me ju vú at’ëmen fëmijvet, qi të jenë shembull urtijet, kënaqja e zemrave e ndera e shtëpisë së tyne”.

Në kreun XXII të librit, që titullohet “Zani i Shëjtut Atë Papë” shpjegohet edhe arsyeja që e shtyu Mjedjen



lirik e gjuhëtar, t’i kushtonte aq shumë kohë biografisë së një Shenjti: “...me ndjekë shembullin e Luigjit, do me thënë me i pergiá e me shkue mbas gjurmëve të tija: bisedat e mira, dishiri per Misjone shëjte, mësimi i të vertetave të Fés, e veprat e mëshirshme gjithnduersh - s’kishte me u lypë tjetër veç njikaq prej moshës së ré katolike, per me persritë Apostullimin e Luigjit, simbas nevojëve të soçme... (gjá qi do të ndikonte në mënyrë vendimtare –shënimi ynë) për mirërritjen e pshtimin e të ríve, sidomos në ket kohën tonë plot me rreziqe për ta...- shkruhet në Letrën Apostolike të Shenjtut Atë Papë”.

Ndonëse shumica e veprave fetare të Dom Ndré Mjedës janë përkthime apo përshtatje, mund të themi me plot gojën se me to Meshtari dha një ndihmesë të shquar për vazhdimin e traditës katolike të përkthimit si dhe të prozës shqipe.

Ndër veprat fetare të Dom Ndré Mjedjes mund të përmendim: “Jeta e Shëjtut Shë Njon Berkmansit” që e përshtati prej italishtes më 1888, kur ishte vetëm 22 vjeç; “Të Pergjiamit e Zojës së Bekueme”, përshtatur prej spanjishtes më 1892, e ribotuar më 1927; “Lumnit e Zojës” përshtatur prej italishtes, botuar më 1929; “Devocioni i Zemrës së Jezu Krishtit”, përshtatur prej frëngjishtes më 1931; “Katekizmi i Madh” përshtatur prej italishtes. Ribotoi edhe 14 Ligjërata të Imzot Pjetër Bogdanit, të cilat i pajisi me një parathënie të vetën me titull: “Jeta e së Lumes Virgjin Mëri nxjerrun prej veprës “Cuneus Prophetarum”.

Pas këtyre përkthimeve, shkroi veprën origjinale “Shën Luigj Gonzaga, Projsi i pergjithtë i moshës së rë”, për çka shkruam më lartë. Një tjetër vepër me karakter fetar është “Historia Shejte” kryevepër e llojit, që bashkon gjuhën e stilin popullor e atë të kultivuar njëherësh.

Vepër e dom Ndre Mjedës është edhe një nga librat më të njohur e më të përdorur të uratave, apo, siç quhet nga populli, oficja: “Visari Shpirtnuer”, e cila përmbledh lutjet e këngët kryesore të Kishës dhe përdoret edhe sot nga besimtarët.

Duke lexuar veprat me tematikë fetare të Dom Ndre Mjedës së madh, ndjejmë gati po atë kënaqësi që buron nga kryeveprat e tij lirike, sepse janë shkruar me dorë mjeshtri, artisti e shkencëtari, e prandaj zgjojnë interesimin e jashtëzakonshëm.

Redaksia

SHËN RROKU, PAJTORI I FAMULLISË SË SHIROKES



dhe më e bukur se ishte. Kisha iu kushtua Shën Rokut, si Pajtori i famullisë, i njohur edhe si mbrojtës i njerëzimit kundër epidemive dhe murtajës që kremtohet me 16 gusht.

Projekt i kishës ju besua Kolë Idromenos, arkitektit e artistit të famshëm shkodran të asaj kohe. Kisha, e ndërtuar në stil klasik, u realizua në vitin 1906, njëkohësisht u ndërtua edhe ura e lëvizshme mbi lumin Buna, që mundësonte drejt qytetit, që deri në atë kohë bëhej i mundur vetëm me barka.

Kisha u ndërtua nën kujdesin e famullitarit të Shirokës, Dom Gjon Bushatit, ndërsa

kambanorja në kujdesin e Dom Pashko Zojzit. Për ndërtimin e këtyre objekteve krahas ndihmës financiare të familjeve të pasura, ndihmuan me punë vullnetare edhe vetë shirokasit.

Sipas përshkrimit të Gj. Sheldisë, kisha ishte e bukur, simpatike dhe mjaft e madhe “.. si ma e mira kishëz e qytetit, se ma ndër katunde nuk e kishte çiftin askund”.

Me 16 gusht u kremtua festa e Shën Rrokut në famullin e Shirokës. Mesha u mbajt nga Dom Artur Jaku, rektor i Shenjtërores, “Nana e Këshillit të Mirë” ku me mesazh iu drejtua besimtarëve: *“Po kremtojmë një festë të rëndësishme. Shën Rroku ishte simbol i të mirës, dhe sakrificës. Ashtu sikurse e tregojnë edhe pamjet tek statuja e tij, ai ishte i prekur nga murtaja. Mirëpo asnjëherë nuk u ankua dhe u shërbeji të tjerëve që ishin të sëmurë. Ai nuk mundi as të ushqehet, dhe Zoti tregoi një ndër mrekullitë e tij, teksa i dërgoi një qen i cili mbante ushqim...”*

Në vazhdim foli për rendësin që kishte kjo Kishë në të kaluarën për shirokasit dhe shkodranët që vinin me kënaqësi buzë kësaj pjesë të liqenit për tu lutur e dëfryer nga fresku i majës së Taraboshit e bjeshkëve të Rumisë së zonës së Krajës.

Nga predikatori morëm dhe këto shënime për të kaluarën e Kishës.

Në fillim të 1900-ës shirokasit kërkuan dhe ia arritën që të ndërtohej një kishë e re, më e madhe





Kolë Ashta

**FJALORI I GJUHËS SË
NDRE MJEDË**

Botimet Fiorentia, Shkodër 2023



At Pashko Bardhi, OFM

**MISCELLANEA I
"ALBANIA"**

*Botime Françeskane,
Shkodër 2022*



Edwin E. Jacques

**ISLAMIZIMI I SHQIPËRISË
NËN TURQIT**

Botime Alsar, Tiranë 2019

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në eleven studio - www.11stud.io

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXVI, nr. 7/8 (569-570) Korrik - Gusht 2023